



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 SHTATOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

*(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)
(Seanca filloi në orën 10:00)*

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 06.09.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”” *(neni 85 i Kushtetutës, neni 86 i Rregullores, votimi për rrëzimin e dekretit me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar”” *(nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 SHTATOR 2018

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

6. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Ulemi, kolegë deputetë!

Atëherë, seancën e sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Ju njoftoj se vazhdon puna në komisione për shqyrtimin e çështjeve të tjera të parashikuara në seancë plenare, sipas kalendarit trejavor të miratuar.

Ka ndonjë vërejtje nga kolegët lidhur me procesverbalin e seancës së kaluar? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njoftim:

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar katër projektligje, ku dy prej tyre janë kërkuar me procedurë të përshpejtuar, por, bazuar në pikën 5 të nenit 28 të Rregullores, Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se një projektligj për kalendarin trejavor. Prandaj, kërkesa për njërin prej këtyre projektligjeve do të bartet për kalendarin e ardhshëm trejavor.

Njëherazi, edhe nga deputetët, janë depozituar dy projektligje dhe një interpelancë, ku njëri nga projektligjet është nisma ligjore për rishikimin e Kushtetutës, propozuar nga opozita. Në mbështetje të gurmës “a” të nenit 77 të Rregullores së Kuvendit, kjo nismë futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit. Tekstin e projektligjit, sipas Rregullores, e keni të gjithë përpara, si dhe të gjitha materialet do t’i gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime

dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Sipas nenit 86 të Rregullores, nga Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat kush e do fjalën? Zoti Braçe është prezent?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është?

Atëherë, sipas Rregullores, ministri përkatës ka ndonjë gjë për të shprehur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ahmetaj, keni ndonjë gjë lidhur me dekretin?

(Ministri Ahmetaj flet nga vendi pa mikrofon.)

Fjala është për ju.

Arben Ahmetaj – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Dua ta përdor momentin e shqyrtimit të dekretit të Presidentit për ligjin e të ardhurave për ta sqaruar edhe një herë opinionin publik se për çfarë bëhet fjalë në të vërtetë. Gjithashtu, duke përfutur nga momenti, dua të ndaj me qytetarët dhe me aktorët ekonomikë të fushës, dhe jo vetëm, apo edhe me forcat politike qëndrimin e qeverisë për sa i përket debatit për lojërat e fatit, por edhe vazhdimësisë së këtij nënsektori duke filluar që nga 1 janari i vitit 2019.

Tani, do ta marr me ngadalë dhe do të ha pak kohë për t’i sqaruar qytetarët se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Për çfarë ligji bëhet fjalë? Çfarë ka kthyer Presidenti i Republikës?

Presidenti i Republikës ka kthyer me dekret ligjin e të ardhurave. Por çfarë ka ndryshuar ligji i të ardhurave? Ligji i të ardhurave ka ulur tatimfitimin nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, pra ne kemi ndërmarrë një politikë fiskale të rëndësishme në favor të bujqësisë dhe ky ligj është një pjesë e politikës fiskale në ndihmë të sektorit të bujqësisë. Ne u kemi ulur shoqërive të bashkëpunimit bujqësor tatim-fitimin nga 15% në 5%.

Çfarë kemi bërë tjetër me këtë ligj? Gjithashtu, me këtë ligj i kemi ulur taksën nga 15% në 5% një game të gjerë biznesesh me 8-14 milionë lekë xhiro.

Kemi rritur një taksë, atë të Lotarisë Kombëtare nga 10% që ishte, në 15%.

Një qytetar apo kushdo qoftë, që më dëgjon, mund të thotë: si ka mundësi që

Presidenti i Republikës e ka rrëzuar këtë ligj? A është Presidenti i Republikës kundër bujqësisë? Sigurisht, jo.

A është Presidenti i Republikës kundër kësaj fashe biznesi, së cilës ia ulëm taksën nga 15% në 5%? Jo.

A është Presidenti i Republikës në mbështetje të idesë që lojërave të fatit t'u ulët ngarkesa fiskale? Jo.

Unë besoj se ka një keqkuptim në dekretin e Presidentit. Dikush, që ka detyrën të jetë më diligjent me letrat, e ka këshilluar atë gabim, sipas mendimit tim.

Ajo që ne po bëjmë këtu është e thjeshtë. Ne po e rrisim tatim-fitimin në konceptin e shkruar në ligjin e vitit 2015 për Lotarinë Kombëtare nga 10% që ishte, në 15%. Ku është ulja e ngarkesës fiskale për lojërat e fatit këtu? Kjo ishte e para.

E dyta, që është po kaq e rëndësishme: mos harroni se Lotaria Kombëtare ishte e vetmja kompani në këtë sektor, që taksohej jo 15%, por 10%. Pse ta taksonim më pak këtë kompani? Cila ishte arsyeja? Nuk kishim arsye dhe prandaj unifikuam taksimin. Për këtë arsye, dua t'u kujtoj të gjithëve se e gjithë boloria e debatit emocional politik se kush është kundër lojërave të fatit, është qesharake. Kjo është shumë e qartë.

Dua t'u kujtoj qytetarëve se në vitin 2005 taksimi për lojërat e fatit ka qenë 20%.

Në vitin 2008 këta që mungojnë sot, ua lehtësuan barrën fiskale lojërave të fatit, duke e bërë nga 20% në 10%. Ne ua rritëm barrën fiskale në 15% për tatimfitimin, plus 5% në favor të çështjeve të mira, pra e bëmë 20%. Këtu mbyllet debati i pabazë dhe qesharak pseudoantievazionist, që bëjnë shumë njerëz në këtë sallë dhe përtej kësaj salle për sa u përket lojërave të fatit.

Më tej, dua të sjell disa shifra, të cilat i kam nxjerrë dje në mediet sociale dhe i kam thënë edhe në mbledhjen e komisionit. Ne nuk kemi dhënë asnjë licencë të re.

Të nderuar dhe të dashur qytetarë,

Ne nuk kemi dhënë asnjë licencë të re. Pra, debatin se kur lulëzuan lojërat e fatit nga pseudoantievazionistët, jua them unë. Deri në vitin 2013 kanë qenë 40 kompani lojërash fati, të cilat jepnin afërsisht 3,7 miliardë lekë, pra rreth 37 milionë dollarë.

Sot janë vetëm 20 kompani lojërash fati, të cilat i paguajnë buxhetit të shtetit afërsisht 5,4 miliardë lekë, pra rreth 54 milionë dollarë.

Mund ta shihni qartë se kur lulëzuan dhe kur u shtuan në numër dhe paguanin më pak dhe se kur u reduktuan në numër dhe paguajnë më shumë. Kjo është e qartë. Para vitit 2013, 40 kompani paguanin 3,7 miliardë lekë dhe pas vitit 2013, janë vetëm 20 kompani lojërash fati, të cilat i paguajnë shtetit afërsisht 5,4 miliardë lekë. Ne nuk kemi dhënë asnjë licencë të re, përkundrazi, nuk kemi rinovuar asnjë NIPT, i cili fiket ekonomikisht në territore të ndryshme të vendit. Ky është qëndrimi ynë i prerë, i cili është materializuar edhe në ligjin për lojërat e fatit. Këtu dua të ndaj me ju një mesazh shumë të rëndësishëm për industrinë dhe për qytetarët: më 1 janar 2019 kazinotë elektronike do të largohen nga qendrat e banuara. Do të zbatohet ligji i vitit 2015. Nuk ka asnjë shans të shtyhet. Në këtë datë do të dalin të gjitha nga zonat urbane. U kërkoj kompanive të fillojnë përgatitjen e largimit nga qytetet dhe nga zonat e banuara në datën 1 janar 2019! Pas kësaj date nuk do të ketë asnjë kazino elektronike të licencuar, që do të funksionojë në zonat e banuara.

Po ashtu, do të fillojë zbatimi i kushtit të distancës 100 metra për pikat e basteve sportive. Kjo është një masë pa kthim. E kemi vendosur bashkë. U shty dy vjet më parë, pra, në fund të vitit 2016 dhe ja ku erdhi dita, që, praktikisht, kjo masë të fillojë të zbatohet në referencë të ligjit. A ka probleme industria? Patjetër që ka. A ka probleme me kontrollin e lojërave të fatit? Sado hapa që kemi bërë, sado më shumë para kemi mbledhur në buxhetin e shtetit, sado kemi reduktuar numrin, beteja me pjesën evazioniste të lojërave të fatit dhe beteja e integritetit familjar për ata që shkojnë dhe harxhojnë paratë e familjes në këto lojëra vazhdon. Në njërin korsi vazhdon beteja kundër evazionit në këtë sektor dhe në korsinë tjetër beteja për të frenuar qytetarët që të luajnë në këto kazino elektronike apo baste sportive dhe instrumentet për ta luftuar janë të shumtë. Hapi i parë konkret është largimi nga zonat urbane, qytetet dhe fshatrat, në destinacione larg qendrave të banuara, që do të dizajnohen edhe për aktivitete të ndryshme, njëri prej të cilëve mund të jetë edhe lojërat e fatit.

Të nderuar qytetarë, në përfundim dhe në referencë të paketës fiskale, nuk ishte ligji për

lojërat e fatit ai që ndryshoi, por ligji për të ardhurat, një paketë e rëndësishme fiskale, me të cilën, së bashku me ndryshimet që do të bëjmë në vjeshtë, do të avancojmë akoma më shumë në favor të sipërmarrjes dhe në ndihmë të qytetarëve të zakonshëm. Pra, pjesa e dytë e paketës vjen me ardhjen e buxhetit për një muaj e gjysmë apo dy muaj në këtë parlament.

Së fundi, dua të ndaj me ju edhe statistikën e djeshme të punësimit. Unë e di shumë mirë dhe kam ndjeshmërinë direkte nëpërmjet diskutimeve me median, portaleve dhe diskutimeve me deputetët, të cilët shkojnë kudo në territore, që papunësia vazhdon të jetë problem.

Të dashur qytetarë, mos harroni se në vitin 2014 papunësia ka qenë 18%, kurse sot është 12,4%. Dikush mund të thotë pse flas me përqindje. Patjetër, përqindjet janë të rëndësishme, por më të rëndësishme janë frymët, jetët, njerëzit, kryefamiljarët, anëtarët e familjeve, që kanë gjetur një punë në këto 4 vjet. Janë 234 mijë qytetarë dhe qytetare kryefamiljarë dhe kryefamiljare, anëtarë familjesh që kanë gjetur një punë në këto 4 vjet. Kjo është gati 35% e kusur e totalit të punësimeve që kanë ndodhur në 30 vjet. Në 30 vjet janë krijuar rreth 680 mijë vende pune dhe punësime, nga të cilat 234 mijë vende pune janë krijuar dhe zënë nga qytetarët në këto 4 vjet. Pse e them këtë, për t'u mburrur ne? Jo, nuk e them për t'u mburrur, sepse jam shumë i ndërgjegjshëm që ka betejë shumë të gjatë në përmirësimin e rritjes ekonomike, por për të treguar që ka shumë shpresë e së bashku do të punojmë edhe për ata të papunë të tjerë.

Janë 76 mijë të papunë të regjistruar në zyrat e punës. Ka shpresë edhe për ata. Për 4 vjet janë krijuar 234 mijë vende pune. Do të vazhdojmë së bashku punën edhe këto 3 vjet e më tej për të përmirësuar punësimin. Janë 76 mijë të tjerë të papunë që nuk janë të regjistruar. Edhe për ata ka shpresë. Kur flasim për punësimin, dua që modestisht ta theksoj se nuk mburremi te qytetarët që kanë nevojë për punë. Nuk ka mburrje. Kjo qeveri nuk mund të mburret, sepse ekonomia ka gjithmonë nevojë të përmirësohet, por e themi si shpresë për ata që do të punësohen.

A e patë dje statistikën e rëndësishme reale të punësimit të të rinjve? Papunësia e të rinjve para disa vitesh ka qenë mbi 33%, kurse tani ka

zbritur afërsisht në 22%. Një i ri apo e re në këtë vend mund të më kthehet me të drejtë e të më thotë pse flas me përqindje. Janë qindra e mijëra të rinj që kanë arritur të gjejnë punë. 22% është akoma shumë. Është më e ulëta në rajon. Ka nevojë të zbresë në një shifër. Duhet bërë shumë punë për aftësimin profesional, por sot nuk do të flas për këtë.

Të nderuar deputetë, është shumë e rëndësishme që duke rrëzuar sot dekretin e Presidentit të mos bëjmë një gjest të rrëzimit të një dekreti, por një gjest të mbështetjes të të gjitha shtresave në nevojë dhe të sipërmarrjes, me vëmendje të plotë të qytetarët. Debatin ynë nuk ka të bëjë fare me lojërat e fatit, por me punësimin dhe vëmendjen për qytetarët e këtij vendi.

Faleminderit dhe ju ftoj me kënaqësi ta rrëzoni dekretin e Presidentit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Kanë regjistruar emrat për të diskutuar deputetët; Braçe, Bushati, Balla, Spiropali, Ekonomi, Beqaj, Bello, Dhima, Xhelili, Manja, Bushka, Felaj dhe Hyseni.

Fjala për zotin Braçe. Të përgatitet zoti Bushati.

Erion Braçe – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Mendoj se debati për dekretin e Presidentit të Republikës është zhvilluar i plotë. Të gjitha informacionet janë dhënë të qarta në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit dhe do të ishte e tepërt të flisja këtu në rast se nuk do të ekzistonin tri elemente:

së pari, thelbi i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, për të cilin kërkon të kthehet pas Presidenti i Republikës;

së dyti, një fakt, që për mua është shumë i rëndë, denatyrimi i institucionit më të lartë të vendit, i institucionit të Presidentit të Republikës, në një institucion propagande;

së treti, shqetësimi real që ekziston në shoqëri për lojërat e fatit, performancën e tyre, natyrisht edhe për fenomenet sociale që shkaktohen nga ky biznes.

Për të tria elementet kam mendimin tim, ndërkohë që për të tretin kam edhe një propozim.

Së pari, dua të theksoj me forcë që Presidenti i Republikës ka kthyer pas një ligj, thelbi i të cilit nuk ka të bëjë me lojërat e fatit,

por ka të bëjë drejtpërdrejt me uljen e tatimit nga 15% në 5% për të gjitha bizneset e vogla dhe të mesme, me xhiro vjetore nga 2-14 milionë lekë të rinj. Është një fashë e konsiderueshme, më masivja e biznesit sot në këtë vend, e cila që nga data 1 janar, me ligjin që Presidenti kërkon të kthejë, do të marrë një favor fiskal, që i jep jo vetëm frymëmarrje, por i krijon mundësi të gjenerojë të ardhura të domosdoshme për të rritur biznesin, natyrisht edhe për të punësuar njerëz të tjerë në këtë biznes.

Së dyti, uljen e tatimit-fitimit për të gjitha shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe blegtoral nga 15% në 5%. Bëhet fjalë për një formë të re të operimit në fshat, që synon në mënyrë të qartë të rrisë produktivitetin dhe të bëjë të mundur që bujqit dhe blegtorët të bashkohen për të garantuar më shumë të ardhura për veten e tyre. Është hera e parë që merret një masë e tillë.

Pa asnjë lloj diskutimi, dua të njoftoj të gjithë bujqit dhe fermerët, që kanë si synim të ndërtojnë shoqëri të bashkëpunimit bujqësor, se që nga data 1 janar edhe ata do ta marrin këtë favor të madh fiskal për sipërmarrjen e tyre.

Së treti, ul tatimin mbi fitimin nga 15% në 5% për të gjithë sipërmarrjen e agroturizmit, një segment i ri i biznesit të turizmit, i cili ka filluar të gjallërohet, veçanërisht në zonat rurale, duke u dhënë një mundësi të re banorëve të këtyre zonave, pse jo edhe emigrantëve të kthyer, që janë me origjinë nga këto zona, të investojnë paratë e tyre në agroturizëm dhe të gjenerojnë të ardhura për familjet e tyre, natyrisht edhe për zgjerimin e aktivitetit.

Pra, në tri raste qeveria vendos të heqë dorë në masë të konsiderueshme nga fitimet e këtyre bizneseve, për t'ua lënë ato drejtpërdrejt sipërmarrësve që merren me këto biznese, bizneseve të vogla dhe të mesme, bizneseve që merren me bujqësi dhe blegtori, si dhe bizneseve të agroturizmit. Ky është thelbi i ligjit.

Përkundër këtij thelbi të ligjit, dekreti i Presidentit të Republikës na sjell në vëmendje rastin më ekzemplar se si institucioni vihet në funksion të propagandës.

Propaganda e ditës, në momentin kur ka dalë dekreti, kishte të bënte me lojërat e fatit. Natyrisht, bëhet viktimitë e kësaj propagande ligji, thelbi i të cilit ka të bëjë drejtpërdrejt me njerëzit, me njerëzit e zakonshëm të këtij vendi,

që merren me sipërmarrje të lirë dhe të ndershme, të vogël dhe të mesme.

Presidenti i Republikës pretendon se ky Kuvend ka ulur tatim-fitimin për lojërat e fatit, sepse sipas tij qenka e vërtetë se ligji aktual i lojërave të fatit apo i tatimit mbi të ardhurat, tatonte me 15% të ardhurat nga xhiroja, jo të ardhurat bruto.

Në fakt, dekreti i Presidentit është i vërtetë fizikisht, materialisht, është ky, por thelbi i tij (kjo që sapo ju citova nga dekreti) është i rremë.

Ligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, nr. 155/2015, në nenin 52 të tij përcakton në mënyrë të qartë se të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit taten në masën 15%, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë.

Pra, ligji, të cilit i referohet Presidenti i Republikës, flet për të ardhurat bruto, nuk flet për xhiron që gjenerohet nga biznesi i lojërave të fatit. Në nenin 4 të po këtij ligji, me titull “Përkufizime”, në pikën 40 të tij thuhet në mënyrë të qartë: “Të ardhurat bruto nga loja është shuma e mbetur e organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.” Pra, është fare e qartë që nuk bëhet fjalë për të ardhura nga xhiroja, por bëhet fjalë për të ardhura bruto, siç shpjegohet në ligjin “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili është adoptuar *mot a mot* edhe në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, për të cilin Presidenti kërkon të kthehet pas.

Natyrisht, ligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i vitit 2015, është votuar në mënyrë të qartë pro nga Presidenti i Republikës, në cilësinë e deputetit të këtij Kuvendi, nga Monika Kryemadhi, në cilësinë e deputetes së këtij Kuvendi, nga deputeti Petrit Vasili dhe të tjerë deputetë të partisë ku ka milituar Presidenti i Republikës dhe, natyrisht, ka marrë miratimin e qartë të tyre, timin jo. Unë nuk kam votuar për atë ligj. Arsyeja ka qenë pikërisht barra fiskale. Kurse të gjithë njerëzit e përfshirë sot në propagandë për lojërat e fatit, kanë votuar në mënyrë të qartë pro ligjit, për të cilin sot po zhvillojnë propagandën në dëm të institucionit më të lartë të vendit, që është institucioni i Presidentit të Republikës. Natyrisht, ka edhe të tjerë që i janë shtuar kësaj propagande. Partia e ish-Kryeministrit Sali

Berisha dhe sot e Lulzim Bashës e ka gojën plot për të akuzuar këtë maxhorancë, sepse, sipas tyre, ka favorizuar biznesin e lojërave të fatit. Dua t'ju sjell në vëmendje vetëm disa të dhëna, që kanë të bëjnë me barrën fiskale mbi organizatorët e lojërave të fatit dhe mbi lojtarët e lojërave të fatit. Në vitin 2005, kur në pushtet ka qenë një maxhorancë e Partisë Socialiste, si kjo e sotmja, tatimi mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit ka qenë 23%, ndërkohë që tatimi mbi të ardhurat personale për individët fitues nga lojërat e fatit ka qenë 20%. Në vitin 2006, sapo në pushtet erdhi Sali Berisha, tatimi mbi të ardhurat personale për lojtarët fitues të lojërave të fatit u bë 0%, ndërkohë që tatimi mbi fitimin u bë 20%. Në vitin 2007 mbeti po kaq. Në vitin 2008, kur partinë e ish-Kryeministrit Berisha e mori peng çmenduria e tatimit të sheshtë, tatimi mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit zbriti nga 20% në 10%, ndërkohë që tatimi mbi të ardhurat personale për lojtarët e lojërave të fatit mbeti 0%. Kështu ka vazhduar deri në vitin 2013, aq sa biznesi i lojërave të fatit mori përmasa dramatike dhe evazioni fiskal, siç do t'ju shpjegoj më pas, mori përmasa skandaloze në favor të organizatorëve të lojërave të fatit.

Në vitin 2014 kjo maxhorancë e ndryshoi menjëherë tatimin mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit, duke e ngritur atë nga 10% në 15%. Në vitin 2015 tatimi për organizatorët e lojërave të fatit dhe tatimi mbi të ardhurat personale për lojtarët fitues nga lojërat e fatit u barazuan në 15%. Ky tatim është edhe sot. Kjo barrë fiskale nuk ka ndryshuar as sot dhe nuk do të ndryshojë as me ligjin e ri që kemi miratuar, i cili do të hyjë në fuqi në datën 1 janar të vitit 2019.

Është shumë qartë se propaganda që buron nga kjo parti, e cila nuk është sot në sallë, dhe që ngrihet deri në nivelin e lartë, te Presidenti i Republikës, nuk ka të bëjë me ne. Të dhënat janë këto, janë të dokumentuara qartë në ligjet respektive, sipas viteve respektive dhe kjo është e vërteta.

A kemi probleme me lojërat e fatit? Po, në gjykimin tim, kemi disa probleme.

Së pari, kemi probleme në zbatimin e ligjit dhe kufizimeve që ai ka vendosur për zhvillimin e aktiviteteve të lojërave të fatit. Kjo ka të bëjë me moshën e lojtarëve që futen atje. Ligji e përcakton në mënyrë të qartë se ndalohe

prezenca e qytetarëve deri në moshën 21 vjeç në ambientet ku luhen lojëra elektronike fati apo edhe baste sportive. Për fat të keq, gjithsecili nga ne e ka evident faktin se të rinj me moshë të tillë i gjen me tepri në pikat e basteve sportive, madje edhe në ambientet e lojërave elektronike të fatit. Këtu ne duhet të kthejmë vëmendjen dhe t'i angazhojmë të gjitha agjencitë ligjzbatuese të shtetit për ta mbrojtur pikërisht këtë fashë moshore, siç e përcakton ligji, dhe për ta larguar nga lojërat e fatit.

Së dyti, ligji e përkufizon në mënyrë të qartë hapjen e lojërave të fatit në territor, veçanërisht të pikave të basteve, "100 metra në vijë ajrore". Por, po të shikojmë në territor, veçanërisht brenda qyteteve të mëdha, kjo distancë, edhe pse është e vogël, në gjykimin tim, përsëri nuk respektohet. Natyrisht, ne duhet të kthejmë vëmendjen tek të gjitha agjencitë ligjzbatuese të shtetit për ta respektuar me forcë këtë lloj detyrimi, i cili kërkon medoemos mbylljen e të gjitha pikave që nuk e respektojnë këtë distancë nga njëra-tjetra apo që nuk respektojnë distancën nga institucionet e arsimit publik, institucionet fetare dhe institucionet e tjera të përcaktuara në ligj.

Së treti, ligji përcakton në mënyrë të qartë ndalimin e reklamimit të aktiviteteve të lojërave të fatit në fasadat e këtyre objekteve ku organizohen këto aktivitete. Për fat të keq, është fakt, fasadat e ambienteve ku organizohen këto aktivitete janë të mbushura me reklama të lojërave të fatit, të basteve sportive dhe të lojërave elektronike. Një faqe muri e zënë plotësisht me këto reklama. Është përsëri momenti që ne të kthejmë vëmendjen tek të gjitha agjencitë ligjzbatuese të shtetit për të bërë të mundur që këto reklama në këto fasada të largohen nga ambientet urbane. Me ligj në kemi synuar t'i bëjmë të padukshme pikërisht për shkak të reklamave, por, për fat të keq, ato janë edhe më të dukshme, sepse ligji nuk po zbatohet.

Së katërti, është evident fakti që edhe mediet janë të kufizuara në mënyrë të qartë, me ligj, të reklamojnë aktivitetet e lojërave të fatit. Çfarë ndodhi? Para dy muajve u zhvillua Kampionati Botëror i Futbollit dhe pothuajse çdo televizion, i joshur nga paraja e lojërave të fatit dhe basteve sportive, reklamoi i ka pasur evidente, agresive, jo vetëm brenda ndeshjeve,

por ka pasur edhe emisione që u janë dedikuar thjesht dhe vetëm basteve.

Kam një thirrje për mediet, të cilat në edicionet e lajmeve bëjnë propagandë të qartë apo lajme kundër lojërave të fatit dhe sapo mbaron edicioni i lajmeve, në emisione të posaçme, vazhdojnë të transmetojnë reklama për lojërat e fatit. Në emër të kujt e bëjnë? Në emër të buxhetit të këtyre televizioneve! Ato duhet ta ndalin këtë për të zhvilluar përgjegjësinë sociale që kanë në momentin kur bëjnë lajmin kundër lojërave të fatit, por edhe në të gjithë fashën orare të emisioneve të tyre. T'i japin fund historisë që, për të sulmuar qeverinë apo këtë maxhorancë me lajme, mbajnë qëndrim parimor dhe më pas menjëherë harrojnë se duhet të mbajnë të njëjtin qëndrim parimor edhe kur arketojnë paratë nga kompanitë e basteve.

Së pesti, ligji ka kufizime të qarta për dëshminë e penalitetit të secilit prej pronarëve të kompanive të lojërave të fatit. Është momenti për ta thënë me plot gojë se në këtë segment të biznesit ka hyrë krimi i organizuar dhe po përdoret paraja e pistë. Pa asnjë lloj diskutimi do të duhet që të gjitha agjencitë ligjzbatuese të shtetit të bëjnë atë që është themelore: veting për të gjithë pronarët e lojërave të fatit, për çdo qindarkë që administrohet prej tyre dhe që, natyrisht, shpërndahet si një fitim te një lojtar, në rastin më fatlum, ose akumulohet si fitim i madh për secilin prej tyre.

Për ta mbyllur, po ndalem te fitimi i tyre. Kam parë të dhënat që nga viti 2010 deri më tani dhe është e paimagjinueshme se si në mënyrë konstante xhiroja apo paraja e luajtur në këto aktivitete është thuhet e njëjtë dhe luhetet nga 13-14 deri në 17 miliardë lekë. Ajo që bie në sy ka të bëjë me vitet 2011, 2012 dhe 2013, është qesharake ta shohësh, por është e dhimbshme të kuptosh se evazioni fiskal në këto vite ka qenë dramatik në favor të kompanive të lojërave të fatit dhe të pronarëve të tyre. Është evidente se xhiroja e këtyre kompanive apo të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i lojërave të fatit janë pothuajse të barabarta me shpenzimet e tyre, që u janë kthyer lojtarëve. Pra, i bie që sa para janë hedhur, aq para janë fituar nga lojtarët, jo nga këta, dhe normat e fitimit mezi arrijnë në 8-9%.

Menjëherë pas aksionit që ndërmoi kjo maxhorancë shifrat jo vetëm që kanë ndryshuar, por bëjnë evident një fenomen të ri, normat

jashtëzakonisht të larta të fitimit të këtyre kompanive: APEX me normë fitimi 39%, ASTRA me normë fitimi 32%, VLT me normë fitimi 50%, Adriatik Game me normë fitimi 21% dhe kazinoja në mes të Tiranës me 32% normën e fitimit për vitin 2017. Në këtë pikë vlen të them dy gjëra.

Së pari, shembullin gjerman, shtetëzimin e lojërave të fatit. Pjesa më e madhe e kazinove apo e kompanive të basteve kontrollohen nga shteti ose shteti merr deri në 80% të të ardhurave të realizuara nga aktiviteti i tyre, në landet respektive.

Së dyti, konfiskimi i fitimit të tyre. Po përdor këtë term dhe nuk kam turp ta them: një tatim progresiv që konfiskon fitimet e tyre deri në masën 50% dhe që normalisht e bën të padobishëm ushtrimin e këtij aktiviteti si biznes. Kjo me një qëllim të vetëm dhe të dobishëm, mbrojtjen e qytetarëve të këtij vendi nga ky aktivitet, që po i shkatërron nga ana ekonomike dhe sociale.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Ju na keni mandatuar që të çojmë përpara reformat, ndryshimet dhe progresin që i duhet Shqipërisë, jo vetëm në fushën e drejtësisë (me reformën në drejtësi), por edhe në ekonomi. Prandaj ftoj kolegët, pa asnjë mëdyshje, ta mbështesin nismën e qeverisë për të përmirësuar performancën ekonomike të Shqipërisë, sepse kjo nuk ka të bëjë fare me rrëzimin e një dekreti presidencial, i cili nuk ka lidhje me ndryshimet që janë propozuar nga maxhoranca.

Janë bërë 8 ndryshime të rëndësishme për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të lehtësuar bërjen e biznesit në Shqipëri, prandaj dua të ndaj tri ndryshimet kryesore me ju. Ky është momenti për t'ua rikujtuar qytetarëve që nuk duhet të humbasin asnjë minutë kohë për të sjellë ndryshime që do të përmirësojnë shumë më tepër klimën dhe standardin e të bërit biznes në Shqipëri. Kryesorja është mënyra se si sot vendosim që gjysma e bizneseve në Shqipëri do të paguajnë vetëm 5% tatim fitimi. E gjithë propaganda demokratike se taksat janë rritur, nuk vlen; gjysma e bizneseve në Shqipëri, nga 8 deri

në 14 milionë lekë, do të paguajë 5% tatim fitimi, prandaj më duket e palogjikshme dhe e pavend ndërhyrja e Presidencës për të vonuar një nismë kaq të rëndësishme.

Pika e dytë shumë e rëndësishme është mënyra sesi biznesi, që ka të bëjë me produktet bujqësore, mund të përmirësohet, të avancojë, të bëhet më konkurrues dhe të mos jetë më problem për Shqipërinë. Ne kemi një problem social, një pjesë e madhe e popullsisë, që jeton në zonat rurale, patjetër duhet të merret me bujqësinë. Si mund t'i ndihmojmë ata? Në ekonominë e tregut të hapur, një mënyrë për t'i ndihmuar është pikërisht ajo që propozojmë sot dhe që kemi propozuar me kohë, por që po mbahet peng nga ky dekret presidencial: ulja e tatimit nga 15 në 5% për çdo kompani, biznes agrar, që do të fillojë të bashkëpunojë duke u bashkuar për të rritur produktivitetin, për të dalë me produkte më me standarde, më të garantuara, pse jo edhe me çmime më të lira në treg. Ne i ftojmë këto biznese që të bashkohen, të bashkëpunojnë, sepse norma e tatimit do të jetë 5%, pra është 1/3 e asaj që ka qenë.

Pika e tretë e rëndësishme është një fushë që ne po fillojmë ta ndjejmë, ta stimulojmë dhe ta ndihmojmë, tani biznesi i turizmit dhe ai agrar mund të bashkohen dhe të funksionojnë më mirë.

Është interesante kur takon të huaj që largohen nga Shqipëria. Shpeshherë kam dëshirë të bisedoj dhe t'i pyes se çfarë u ka pëlqyer më shumë në Shqipëri. Pavarësisht të gjitha vlerave që ne kemi, natyrës, mikpritjes, shpeshherë njerëzit e kanë shumë të thjeshtë të përgjigjen që na pëlqen ushqimi, pra agroturizmi dhe kjo është një pikë e fortë. Nuk është thjesht bregdeti, sepse bregdet ka edhe Greqia, ka edhe Kroacia, por ne kemi një pikë shumë të fortë, e cila patjetër ka të bëjë me shërbimet e turizmit, ka të bëjë edhe me ushqimin, prandaj propozojmë që agroturizmi të ketë një normë prej 5% të tatimit-fitimit, kjo për 10 vjet. Kjo do ta ndryshonte dhe do ta stimulonte shumë agroturizmin.

Agroturizmi duhet të fillojë të mendohet edhe si një mënyrë të jetuari, të punuari, të përfituari, për të nxjerrë fitim në zonat rurale, të cilat e kanë më të vështirë të integrohen sot për sot në ekonominë e zonave të urbanizuara. Në qoftë se agroturizmi fillon dhe bëhet një motor zhvillimi për këto zona, atëherë ne e kemi bërë punën tonë.

Pra, këto janë tri pika shumë të rëndësishme, të cilat mendoj se e ndihmojnë ekonominë shqiptare dhe po mbahen kot peng, nisur nga një logjikë që nuk i mban fare parasysh 8 ndryshimet kryesore që janë sjellë.

Kuptohet se grupi parlamentar i opozitës paguhet nga taksat e qytetarëve shqiptarë për të bërë punën, për të ardhur në Kuvend, për të argumentuar, për të treguar pse gjysma e gotës është bosh. Në çdo demokraci parlamentare maxhoranca tregon gjysmën e gotës plot, ndërsa opozita tregon gjysmën e gotës bosh, por opozita nuk po e bën punën e saj.

Sot opozita vjedh pagat nga qytetarët, opozita sot paguhet nga taksat e qytetarëve, nga të gjithë ju, qytetarë shqiptarë, sepse nuk është këtui për të bërë punën e saj. Nuk ka asgjë të keqe që opozita të shkojë në Durrës, në Elbasan, në Shkodër, le të shkojë edhe në Tropojë, edhe në Pukë, por ditën e enjte duhet të jetë këtui patjetër, sepse për këtë paguhet. Udhëtimet dhe piknikët që bën nëpër Shqipëri mund t'i bëjë edhe ditët e tjera, ndërsa ditën e enjte duhet të jetë e pranishme këtui në Kuvend, të na kundërshtojë ne, ta kundërshtojë edhe qeverinë, patjetër, sepse kjo mund t'i bëjë mirë qeverisë, ta kontrollojë qeverinë.

Sot Shqipëria ka rezultate, sepse kemi një maxhorancë të stabilizuar dhe të qartë. Këta qytetarë para një viti i dhanë kësaj maxhorance, Partisë Socialiste, mandatin dhe të drejtën për të qeverisur për 4 vjet. Pra, nuk është normale që opozita të krijojë këto stuhi në gotë, në atë gjysmën e saj bosh, kur Shqipëria nuk ka as probleme politike, as etnike, as emigracioni, as fetare, si problemet që po ngrenë sot populistët nëpër Europë, sepse gjithçka që bëhet nga opozita ka vetëm një synim, ardhjen në pushtet. Është normale që çdo opozitë të vijë në pushtet, ky është *modus operandi*, ky është instinkti kryesor që ka opozita për të ardhur në pushtet, ndryshe nuk do të ishte opozitë, por në pushtet nuk vihet me çdo çmim dhe duke dëmtuar ekonominë shqiptare.

Në qoftë se opozita do të ishte e pranishme këtui sot dhe do të sillte propozime konkrete, në qoftë se opozita do të ishte këtui sot dhe do të na kundërshtonte duke sjellë argumentet e saj, jo vetëm do ta përmirësonte ndoshta edhe qeverisjen, por do t'i bindte edhe

qytetarët se si punohet dhe avancohet në ekonomi.

Unë pata kënaqësinë dhe nderin ta përfaqësoj Shqipërinë në Këshillin e Europës, në Komitetin Politik e Demokratik që u mbajt në Paris, ku u diskutua mbi një çështje mjaft të rëndësishme, një nga çështjet më kryesore, e cila kishte të bënte me demokracinë dhe me liritë ekonomike. Demokracia ka një simbiozë perfekte me tregun e hapur, me tregun e lirë dhe të dyja këto ndihmojnë njëra-tjetrën. Sipas një studimi të BERZH-it, Shqipëria mori 9 nga 10 pikët e mundshme si një vend që ka një ekonomi të hapur dhe një demokraci funksionale, të cilat kur bashkëpunojnë dhe kur shkojnë mirë bashkë, ndihmojnë ekonominë, ndihmojnë që të rriten të ardhurat për qytetarët, ndihmojnë që demokracia të funksionojë më mirë, sepse nuk është vetëm demokracia që krijon lirinë e tregut, por është edhe liria e tregut, është edhe një treg i hapur ekonomik ai që e ndihmon demokracinë. Pra, të dyja bashkë janë në një martesë perfekte, të cilat në qoftë se funksionojnë sjellin më të mirat për qytetarët e të gjithë Europës, natyrshëm edhe për qytetarët shqiptarë.

Ajo që ne sjellim dhe kërkojmë sot është pikërisht ky progres, i cili duhet të vazhdojë në mënyrë të pandërprerë. Shqipëria nuk është Zvicër, Shqipëria nuk ka qenë Zvicër as në 1990-n dhe nuk do të bëhet Zvicër as nesër, por ama kjo nuk do të thotë se nuk është bërë shumë punë. Politika nuk është bardhë dhe zi, ne nuk jemi e bardha dhe këta janë e zeza, politika ka shumë ngjyra dhe dimensionë ndërmjet dhe të mohosh gjithçka që është bërë vetëm për të ardhur në pushtet në mënyrë të paargumentuar, të pamerituar dhe në mënyrë gati të paligjshme siç bën opozita, nuk është në të mirën e qytetarëve.

Opozita në radhë të parë duhet të meritojë rrogën për të cilën paguhet nga qytetarët shqiptarë, sepse paguhet për të qenë këtu, të paktën Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i LSI-së dhe çdo parti tjetër e vogël, që mund t'i bashkëngjitet. Le të dalin dhe të thonë ç'të duan nëpër qytete, nëpër fshatra, por realitetin nuk mund ta ndryshojnë kurrë. Sa më shumë ta vazhdojnë teorinë e tyre "Ujku, ujku", gjithmonë do të bëhen më të pabesueshëm dhe do të ndodhë po ajo histori që ndodhi në 2017-ën, humbja e zgjedhjeve, sepse ndërkohë

që vazhdojnë dhe thonë se shteti ka rënë, të paktën e kanë thënë 98 herë deri tani: shteti ka rënë, maxhoranca ka rënë, asgjë nuk po ndodh. Kjo...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

...102, unë kisha numëruar 98. Fundi i botës nuk vjen as për 98, as për 102 herë. Opozita duhet të kthehet në Kuvend dhe ta meritojë rrogën.

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Të përgatitet deputetja Milva Ekonom.

Taulant Balla – Kisha dy fjalë për dekretin, për ato dy gisht letër me argumente të Presidentit të Republikës për të justifikuar dekretin e tij. Ne i shqyrtuan me qetësi e dashuri të dy argumentet, por na vjen keq, zoti President, sepse qëndrimi juaj nuk ka lidhje me argumentet që e bashkëshoqërojnë dekretin. Sot ky dekret do të rrëzohet për të vijuar me politikën tonë që ka në qendër të vëmendjes njerëzit e thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi. Nga data 1 janar, zoti President, bizneset e sektorit të lojërave të fatit do të largojnë outletet nga zonat e banuara, sepse nuk do të ketë më kazino elektronike pranë zonave të banuara. Ligji do të jetë tejte i rreptë edhe për pikat e basteve.

Kaq kisha për dekretin e Presidentit.

Më lejoni, kolegë deputetë, që nga foltorja e Kuvendit të Shqipërisë, aty ku deputetët kanë detyrën primare të ushtrojnë mandatin e të zgjedhurve dhe përfaqësuesve të popullit, t'i kthej disa përgjigje një juristi mediokër, që ndoshta ka ardhur momenti t'i kërkojmë edhe diplomën e universitetit, sepse pretendon të jetë jurist, me emrin Lulzim Basha.

Jurist, dole sot në hotelin tënd të radhës dhe akuzove Kuvendin dhe Kryetarin e Kuvendit, se në faqen e internetit nuk po publikohet propozimi yt po aq mediokër sa edhe argumenti që bëre sot.

O jurist, o Lulzim! Rregullorja e Kuvendit ka një nen, neni 77 "Për shqyrtimin e nismave ligjore për rishikimin e Kushtetutës". O jurist, o Lulzim, e ke depozituar propozimin ditën e premte. Seanca e parë e Kuvendit është sot, nga dita e premte. Ka dëgjuar njeri të ketë pasur ndonjë seancë tjetër plenare gjatë këtyre ditëve

dhe juristit Lulzim i është mohuar e drejta e propozimit?! Jo s'ka pasur! Rregullorja e Kuvendit thotë fjalë për fjalë, o jurist, o Lulzim: "Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të merret nga jo më pak se 1/5 e anëtarëve të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin në seancën plenare (o jurist, o Lulzim) më të parë dhe u shpërndan deputetëve tekstin e projektligjit. Projektligji futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit".

Në orën 10:03 minuta Kuvendi i Shqipërisë u njoh me propozimin. Në tavolinat përballë karrigeve bosh të juristit Lulzim dhe të deputetëve *part-time* të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të opozitës, janë të gjitha kopjet e projektligjit të firmosura nga juristi Lulzim bashkë me deputetët e tjerë. Prej orës 10.03 minuta, sipas Rregullores, siç ka ndodhur gjithmonë prej shtatorit të vitit të kaluar, ku Kuvendi i Shqipërisë respekton Rregulloren, menjëherë ky material së bashku me materialet e tjera të depozituara në Kuvend është i aksesueshëm për qytetarët.

O jurist, o Lulzim, je i lutur t'i ndërpresësh ekspeditat turistike nëpër hotelet e Shqipërisë! Me ç'kuptoj, javën tjetër mund të jesh në Vlorë, e cila këtë vit ka qenë më plot se kurrë me turistë. Shijoje edhe ti Vlorën, se për mua është ndoshta më e mirë se Amsterdami sa i përket aspektit turistik!

Më lejoni, kolegë deputetë, t'ju them shkurtimisht disa vlerësime për këtë nismë që kemi përpara, nuk ka asnjë dyshim që kjo është përpjekja e fundit për të penguar vijimin e reformës në drejtësi. Jo vetëm është cungim, por është një ferrë, një trung ferrash para vetingut të vërtetë të politikës shqiptare.

E kemi votuar këtu, e ka votuar edhe juristi Lulzim, (Më falni, Juristi Lulzim ka qenë atje në lozhë, ishte vëzhgues, por kolegët e tij e kanë votuar dy vjet më parë) sipas nenit 148, germa "dh", të Kushtetutës, kemi ngritur në këtë sallë dy vjet më parë Prokurorinë e Posaçme, e cila do të ushtrojë ndjekjen penale dhe do të përfaqësojë akuzën në emër të popullit shqiptar para gjykatave të posaçme për vepra penale të kryera nga zyrtarët e lartë publikë, qofshin këta politikanë, ministra, kryeministra apo presidentë Republike. Ky është institucioni i vërtetë që heton dhe veton politikën, dhe po ashtu në nenin 75, germa "a", janë përcaktuar kompetencat e

gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Është ligji i SPAK-ut, Lulzim, vetëm ai dhe BKH-ja mund të vetojë politikanët, se cili nga shqiptarët do të më besojë që unë mund të jem i pavarur, objektiv në vetingun tënd, të Saliut, apo anasjelltas? Për mua, ti, Lulzim, vetingun nuk e kalon kurrë me ç'ke mbi supe, aq më shumë Saliu! Por nuk mund ta bëj unë vetingun tënd, Lulzim! Vetingun tim, tëndin, të Ilir Metës, të Edi Ramës e kujt do tjetër mund ta bëjë vetëm SPAK-u dhe BKH-ja, sepse neni 9, pika 2, e ligjit për SPAK-un, përcakton: "Prokuroria e Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale ka kompetencë nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar". Ja pra, Lulzim, është ligj edhe çështja e lidhjes së politikës me elementë kriminalë. Mezi ç'pres të të kem përballë e të të them se ku dalloj unë nga ty, sepse në fund të muajit gushtit ke hedhur gjithë atë lumë akuzash të padrejta ndaj meje.

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10192 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimet e tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", është ligji antimafia, Lulzim, i cili nuk ka nevojë për ndryshime kushtetuese, por duhet të presim edhe pak javë, pas gjithë atyre përpjekjeve që bëre ti bashkë me shpurën tënde, që SPAK-u dhe BKH-ja të fillojnë punë. Në mënyrë të menjëhershme të hetohen të gjithë politikanët, por edhe familjarët e tyre, Lulzim! Është neni 133, pika 2, i cili përcakton kompetencën vendore të gjykatave të posaçme për të gjykuar zyrtarët e lartë shtetërorë për veprat penale të kryera prej tyre, dhe neni 148, germa "dh", i cili i jep kësaj prokurorie të posaçme të ushtrojë ndjekje penale dhe të përfaqësojë akuzën para gjykatave të posaçme për këto vepra penale.

Nisma jote, Lulzim, thënë troç, është që politika të autovetojë vetveten. Vetingun e politikës nuk mund ta bëjnë dot vetë politikanët apo disa kukulla të zgjedhura prej tyre, por organet e pavarura të drejtësisë dhe institucionet

kushtetuese të monitoruara nga Bashkimi European. Në fakt, nuk ka nevojë t'ju kesh përballë për të kuptuar se çfarë halli keni, ju mjafton t'ju dëgjosh dhe dilni shprehimisht dhe shumë qartë te halli që keni. Një përfaqësuese e nderuar e opozitës tha se nuk doni që në vettingun e politikës të jenë edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë, ndërsa një përfaqësues tjetër i opozitës thotë se iu janë bërë këta ndërkombëtarët si guvernatorë.

Jo, nuk janë guvernatorë as ekspertët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as ata të Bashkimit European, as ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as ai i Bashkimit European, janë miq shumë të mirë të Shqipërisë, që e kanë asistuar reformën në drejtësi prej ditës së parë dhe që, sigurisht, ne me atë që kemi votuar së bashku, Lulzim juristi, iu kemi dhënë atyre të drejtën që në dy vjetët e parë, nga dita e krijimit të BKH-së, Byroja Kombëtare e Hetimit, ose FBI-ja e re shqiptare, të asistohet tërësisht nga ekspertët e SHBA-ve dhe nga ata të Bashkimit European.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Taulant Balla- Ju lutem, zonja drejtuese e seancës, po flas në emër të grupit.

Dua të them shumë qartë se kjo iniciativë do të ndjekë të gjithë procedurën e vet parlamentare pa asnjë mëdyshje. Duhet ta kuptojnë të gjithë shqiptarët që pas muajsh përpjekje për të ndalur reformën në drejtësi, ngritjen e SPAK-ut dhe BKH-së, tani që institucionet kushtetuese po përmbyllin vettingun e atyre që do të përbëjnë SPAK-un, kur jemi pak javë larg ngritjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, vjen kjo iniciativë e Lulzim Bashës, e cila është një përpjekje e kotë për të dobësuar kompetencat e SPAK-ut dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe për t'i zëvendësuar ato me gjoja veting.

Shkurtimisht po them 4 gjëra që duhet t'i ketë në mendje çdo qytetar shqiptar kur të dëgjojë shakanë më të madhe të kësaj vjeshte, nga një njeri që përbetohej pranë monumentit të Azem Hajdarit se do të pastrojë politikën, një person ky mbi kurrizin e të cilit rëndojnë akuza nga më të rëndat ndaj politikës shqiptare.

Nuk bëhet vetingu i politikës nga vetë politikanët. Ky propozim, Lulzim, nuk merret me pasurinë e politikanëve, 27- vjet korrupsion i pahetuar në asnjë rast; nuk merret me familjarët

e politikanëve, aty ku, në fakt, fshihen prej vitesh pasuritë e korrupsionit dhe nuk merret me dënimin e politikanëve të korrumpuar, qofshin ata edhe të lidhur me krimin.

Tërhiqe mbrapsht, Lulzim, shpifjen tënde të radhës, gënjeshtren tënde të radhës! Unë do ta them gjithmonë se një herë në jetën time i kam dhënë të drejtë Jozefina Topallit dhe do ta them sa herë të kem mundësi se ty, Lulzim, të të pyesësh edhe sa është ora, gënjen, jo më të të besosh për gjëra të tjera.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka deputetja Milva Ekonomi.

Milva Ekonomi - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në këtë sesion parlamentar socialistët vazhdojnë të mbajnë vëmendjen të përqendruar te njerëzit, te përparimi i vendit dhe te përmirësimi i legjislacionit, i cili vjen në funksion të zhvillimit. Prandaj sot, me përgjegjësi ne rimarrim në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr.10 805, datë 30.07.2018 “Për kthimin dhe për rishqyrtimin në Kuvend të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

Në fakt, që në sesionin e kaluar kur ky projektligj u diskutua kishte për qëllim disa gjëra shumë të rëndësishme, që lidhen me zhvillimin ekonomik të vendit.

Së pari, synon t'u japë një nxitje fermerëve për t'u përfshirë në shoqatat e bashkëpunimit bujqësor duke reduktuar normën e fitimit kooperativ nga 15-5%.

Së dyti, kërkon që bizneset, që janë një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, siç është agroturizmi, të kishin lehtësira në ofrimin e produkteve të tyre duke ia ulur edhe atyre normën e fitimit kooperativ nga 15% në 5%.

Së treti, ne kemi kohë që kemi nisur një iniciativë, që ka të bëjë me formalizimin e ekonomisë dhe për këtë arsye biznesi i vogël është vazhdimisht i mbështetur me reforma nga qeveria, por në këtë rast në tatimin mbi fitimin bëhet fjalë për një shkallëzim të normës së fitimit. Për ato biznese që kanë deri në 14 milionë të ardhura vjetore, tatimfitimi propozohet 5% para tatimit, ndërsa për atë biznes që bën të ardhura mbi 14 milionë

propozohet që tatimfitimi të mbetet 15% e fitimit para tatimit.

Gjithashtu, edhe diçka tjetër e rëndësishme, që lidhet me sektorin e ndërtimit u mor në konsideratë, sepse ka të bëjë me barazinë e barrës fiskale ose ndarjen e saj midis atyre që janë investitorë dhe ndërtues në fushën e ndërtimit. Të gjitha amendamentet, edhe amendamenti i fundit, ai i lojërave të fatit, i cili, në fakt, nuk bën ndonjë ndryshim të madh përveçse barazon, reciprotizon tatimin e vendosur mbi të gjithë ata që janë operatorë të lojërave të fatit, duke e çuar atë në 15%, përfshihen në mënyrë koherente edhe te ligji “Për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vitin 2008.

Nuk duhet të harrojmë për asnjë moment se ndryshimet e fundit, ato që kanë të bëjnë me lojërat e fatit, i takojnë objektivit që ka vënë qeveria socialiste: të gjithë operatorët e lojërave të fatit të largohen nga zonat e banuara në janar të vitit 2019. Për këtë arsye, çdo masë legjislative që merret synon të shkëpusë vëmendjen e grupeve vulnerabël, por edhe të rinjve, që janë në moshë shkollorë, ose të fillimit të punës, nga ky aktivitet që ndodh në qytetet tona.

Unë dua të them se, përveç diskutimeve të rëndësishme që janë bërë për lojërat e fatit, kam përshtypjen se Presidentit i ka shpëtuar një fakt kaq i rëndësishëm, siç është reciprociteti dhe parimi i një sistemi të rreptë fiskal, që duhet vënë për lojërat e fatit. Prandaj, besoj se të gjithë kolegët deputetë, anëtarët e Partisë Socialiste dhe anëtarët e maxhorancës duhet ta shohin me vëmendje këtë projektligj dhe ta votojnë si të tillë.

Ky nuk është i vetmi diskutim i rëndësishëm në këtë sallë, sepse vëmendja e të gjithëve është përqendruar në një nga çështjet më të nxehta parlamentare, siç është nisma e grupit opozitar lidhur me vetingun e politikës. Ju kujtoj se nuk ka kaluar shumë kohë nga momenti kur reforma në drejtësi mori nota shumë të larta nga monitorimi që bënë aktorët ndërkombëtarë lidhur me atë që solli hartimi, ndryshimi i legjislacionit, zbatimi dhe implementimi që pati reforma në drejtësi në Shqipëri. Edhe pse ky proces ishte pak i ngadaltë, reforma në drejtësi ishte një nga reformat që e bëri Shqipërinë vend model për ta

marrë dhe për ta aplikuar edhe në disa vende të tjera të Ballkanit.

Dua t’u them qytetarëve shqiptarë se koha kur dëgjoni nga politikanët cilësime për një administratë të korruptuar, abuzuese me fondet publike, e lidhur me krimin e organizuar, apo koha kur zyrtarë dhe politikanë të lartë stigmatizoheshin si të korruptuar, hajdutë, mafiozë dhe vrasës ka mbaruar. Pavarësisht këtyre shpifjeve dhe stigmatizimeve, asnjëri prej tyre nuk ka marrë fajësinë apo pafajësinë nga gjykatat dhe pikërisht reforma në drejtësi sjell shanse të barabarta që kjo të ndryshojë njëherë e mirë.

Të gjithë e dimë se shtylla kurrizore e kësaj reforme është vetingu i gjykatësve dhe prokurorëve, i cili është në përfundim e sipër. Vetingu ka nxjerrë jashtë sistemit gjyqtarë dhe prokurorë që nuk e kanë justifikuar pasurinë e tyre. Ne e dimë shumë mirë që të zbulosh krimin nuk është e lehtë, por duhet të ndjekësh me shumë kujdes rrugën nga vijnë paratë dhe nga është burimi i tyre. Ky proces që u bë për gjykatësit dhe prokurorët, do të bëhet edhe për politikanët, por tashmë do të bëhet nga struktura të ngritura sipas parimeve kushtetuese, që janë Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Struktura e Posaçme Antikorrupsion. Ky është një proces gjithëpërfshirës për të gjithë politikanët. Opozita, e drejtuar nga Partia Demokratike, kërkon të bëjë sa më parë vetingun në politikë, pa pritur ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit apo SPAK-ut. Një projektligj i depozituar në Kuvend, për të cilin sot jemi vënë në dijeni, tregon se ata kërkojnë të ngrënë mekanizma të rinj kushtetues dhe të nxjerrin jashtë loje Byronë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-un. Me këtë propozim Partia Demokratike e sheh vetingun e politikanëve si një akt administrativ pastrimi dhe jo si një akt ndëshkimi.

Reforma në drejtësi i ka dhënë fuqinë SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit që ata të mos e kalojnë thjesht lidhjen e politikanëve me krimin, por, mbi të gjitha, të kontrollojnë pasuritë dhe të ardhurat e tyre. SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit nuk duhet të ndalen vetëm te politikanët, por edhe te pasuria e familjarëve të tyre. SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit nuk mjaftohen vetëm me largimin e politikanëve të lidhur me krimin, por

garanton që ndaj këtyre politikanëve të merren edhe masa ndëshkuese.

Kjo nismë nuk është gjë tjetër vetëm propaganda e radhës që po bën opozita. Edhe pse në letër, ajo tregon se kjo parti nuk është gati për një veting të politikës, por është gati të bëjë një politikë me vetingun. Ndërkohë që përmes SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit vetingun e politikës nuk e bëjnë politikanët, apo ata që janë zgjedhur prej tyre, por organet e pavarura të drejtësisë dhe institucionet kushtetuese, të cilat monitorohen nga Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Socialistët, që në krye të herës, janë treguar të gatshëm për vetingun e vërtetë, prandaj e kanë mbështetur që në fillim reformën në drejtësi, gjithashtu, kanë mbështetur fuqimisht ngritjen e SPAK-ut dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit për të ndëshkuar të gjithë politikanët e korruptuar.

Reforma në drejtësi jep një garanci 100% për një veting real, por, sidoqoftë, socialistët janë të hapur të mbështesin çdo propozim që përshpejton këtë proces, pra që reforma në drejtësi dhe ngritja e institucioneve të pavarura, që kanë të bëjnë me vetingun e politikës, të mos ndalen. Ne, socialistët, e shohim si ushtrim demokracie faktin se duhet të diskutojmë çdo propozim, në qoftë se ai është i duhuri dhe shpejton këtë proces.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Fjalën e ka deputeti Ilir Beqaj. Të përgatitet deputetja Vilma Bello.

Ilir Beqaj – E nderuar drejtuese e seancës, Zonja dhe zotërinj deputetë,

Lidhur me vlerësimet për dekretin e Presidentit, nuk besoj se duhet të shtoj më shumë përveç asaj që parashtroi kolegu Braçe se dekreti nuk duhet pranuar, qoftë për thelbin e asaj që u miratua në korrik, qoftë për arsyet e përmbajtjes, por edhe ku duhet vënë dorë për zbatimin e ligjit për lojërat e fatit.

Meqenëse po flasim për tatimin mbi të ardhurat, unë mendoj se është momenti të bëjmë një bilanc se çfarë ka ndodhur me sistemin fiskal në Shqipëri këta 5 vjet. Për çfarë u angazhuam? Çfarë është arritur? Çfarë përmirësimesh kanë dhënë këto arritje në jetën e qytetarëve, në

familjet shqiptare, në sipërmarrjen shqiptare dhe në zhvillimin ekonomik të vendit?

Tashmë prej vitesh në Shqipëri ka një mënyrë të taksimit progresiv të të ardhurave nga puna. U angazhuam dhe e zbatuam. Sot me dhjetëra e mijëra infermierë, mësues, mjekë, policë, ushtarakë, nëpunës, por edhe punëtorë në sektorin privat taten jo më 10%, por taten sipas pagës, efektivisht 4, 5 apo 6%. Në fund të vitit të gjithë këta kanë marrë një pagë neto më shumë. Nëse në 4 vjet kanë marrë në dorë 4 paga neto më shumë, do të thotë që një familje e re ka mundësi të blejë edhe një televizor, edhe një lavatriçe, edhe një frigorifer apo ka mundur të kursejë për të bërë edhe pushime në stinën e verës në mënyrë më dinjitoze. Nëse të ardhurat nga tatimi mbi pagat në vitin 2017 janë baras me vitin 2018 si fonde, kjo ndodh për shkak se të punësuarit në vitin 2017 janë 220 mijë vetë më shumë. Ndërkohë, ne u angazhuam se do të rrisim tatimin për biznesin e madh. Praktikisht nëse në 4 vjet të ardhurat nga ky tatim, pra edhe vetë fitimet e kompanive, janë rritur gati 2 herë, ndërkohë që norma tatimore është rritur 50%, tregon se kjo politikë fiskale, ndryshe nga sa u akuzuar, nuk e ka penguar sipërmarrjen, ka vazhduar të ketë zhvillim ekonomik, kompanitë kanë pasur më shumë fitime dhe për pasojë, sigurisht, kemi pasur edhe më shumë të ardhura nga tatimi i kompanive të mëdha. Për biznesin e vogël nëse u angazhuam për përgjysmimin e taksave, për një pjesë të tyre me xhiro 2-5 taksën e bëmë zero. Në korrik ne miratuam (dhe hyn në fuqi në janarin e vitit të ardhshëm) që biznesin me xhiro nga 8 milionë deri në 14 milionë ta tatojmë deri në 5%. Po për tatimin mbi të ardhurat në sektorë të caktuar, ku mendojmë se duhet të nxisim edhe më shumë zhvillimin, kemi normë tatimi mbi fitimin shumë më të ulët, 5%.

Në industrinë e *software*-it në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, në agroturizëm për kompanitë prestigjioze që do të investojnë në turizëm tatimin, për 10 vjet e kemi 0%. Besoj se është pikërisht kjo politikë fiskale që, veç të tjerave, ka ndihmuar edhe në përmirësimin e situatës ekonomike.

Këtë fillim jave dy publikime të rëndësishme, ai i Bankës së Shqipërisë dhe i INSTAT-it, na treguan se bilanci i pagesave është përmirësuar në tremujorin e dytë në

krahasim me një vit më parë. Kemi një bilanc shumë pozitiv në shërbime, qoftë në vlerën e shtuar që krijohet nga material porositësi apo edhe në turizëm. Këto janë arsyet reale pse prej muajsh kemi një situatë të forcimit të lekut edhe kundrejt euros, edhe kundrejt dollarit. Pa dyshim qoftë punësimi, qoftë rritja e fitimeve do të sjellin edhe më shumë investime të tjera, siç tregohet në mbajtjen përsëri lart të investimeve të huaja direkte, por edhe në faktin që Shqipëria, gjithmonë dhe më tepër, importon më shumë makineri dhe pajisje, që do të thotë më shumë linja të reja teknologjike, më shumë punësim, më shumë vlerë e shtuar.

Sfidat e biznesit në 4-5 vjet kanë qenë politikat fiskale, ka qenë sistemi i drejtësisë, ka qenë vetë biznesi, sidomos shoqatat e sipërmarrësve të huaj, që për sistemin e drejtësisë kanë pasur ankesat më të mëdha.

Ne morëm angazhimin për të reformuar sistemin e drejtësisë, e filluam, por ka pasur disa vonesa, sepse praktikisht është e qartë se në miratimin e etapave të ndryshme të zbatimit të reformës opozita më shumë ka qenë e shtrënguar të votojë nga halli, jo me dëshirën e saj. Edhe tani, kur dy instrumentet kryesore të zbatimit të reformës, sidomos për të shmangur ndikimin e politikës te drejtësia apo për t'u dhënë imunitet politikanëve të korruptuar po bëhen gati, Partia Demokratike vjen me një propozim të ri, me të cilin as vetë ajo nuk e ka të qartë se çfarë kërkon, por thotë: “Të ndryshojmë një herë Kushtetutën, pastaj për ligjin e veçantë të shikojmë se si do të bëjmë”, ndërkohë që në të gjithë botën demokratike drejtësia duhet të lihet e pavarur, që të thotë fjalën e saj për atë që ndodh në vend, sidomos për akuzat e politikanëve. Opinioni e ndoqi, që pas nismës së parë dhe pas pranimin nga Edi Rama, opozita filloi të thoshte: “Jo, nuk kemi punë me familjarët!”. Në këtë parlament apo në politikë, madje edhe këtu në këtë sallë, është folur edhe për baxhanakë, edhe për kunetër, sidomos duke filluar nga një njeri, që çfarë nuk ka thënë, ka bërë çdo lloj akuze. Ne gjykojmë se nuk mund të bëhet e plotë nëse nuk shtrihet edhe në një rreth të caktuar të familjarëve. Mbajtja e fokusit vetëm te politikanin, me një instrument administrativ do të thotë të tallesh edhe me vetveten, edhe me Kushtetutën, edhe me reformën në drejtësi.

Megjithatë, unë vetë u bashkohen atyre që u thanë këtu se do të ishte shumë mirë që diskutimin e plotë, shterues ta bëjmë duke u bazuar në atë nismë, në propozimet për ta zgjeruar dhe për ta thelluar për të kuptuar qartë se kush e do reformën në drejtësi dhe kush do ta pengojë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjalën e ka deputetja Vilma Bello, e më pas zëvendëskryeministria Senida Mesi.

Vilma Bello – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sigurisht, diskutimi për dekretin e Presidentit në këtë seancë ka rëndësinë e vet, por edhe qëndrimi ynë për ta rrëzuar këtë dekret u bë i qartë prej kolegëve që diskutuan në lidhje me të.

Personalisht, mendoj se sot ka diçka më të rëndësishme për të diskutuar, për ndjeshmërinë që kanë qytetarët e këtij vendi, e padyshim edhe për vëmendjen tonë ndaj njerëzve. Është çështja e vettingut në politikë ajo që na detyron të gjithëve të themi se sa rëndësi ka për ne reforma në drejtësi, ecuria e së cilës sigurisht do të prodhojë gjithçka që lidhet me atë që qytetarët shqiptarë presin prej nesh, qofshin ose jo votuesit tanë. Sigurisht, ne si maxhorancë kemi çfarë të themi sot.

Të dashur bashkëqytetarë, e kam të pamundur të mos kthehem pas në kohë, që të kujtoj përpjekjet e pafundme dhe artificet e opozitës për të mos e pranuar vettingun në drejtësi. Apo opozita e ka harruar se në ç'gjendje ishte vendi nën qeverisjen e tyre? Ky qëndrim i opozitës nuk përbën më çudi për ne, e padyshim as për shqiptarët.

Ishim ne të parët që ngulmuam për reformën në drejtësi, ndërkohë që opozita zgjidhte bojkotin dhe braktisjen e seancave parlamentare, sikundër po bën edhe sot. Pavarësisht përpjekjeve të tyre për ta deformuar atë, vetingu ka nisur ta pastrojë sistemin e drejtësisë, duke identifikuar e më pas duke penalizuar gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar.

Asnjë qytetar i zakonshëm i këtij vendi nuk mund të harrojë se kjo opozitë është e njëjtë me atë të disa muajve më parë. E njëjta opozitë na vjen sot me një kërkesë për vetting në politikë, se

Lulzimi na paska marrë mesazhe mbështetjeje për këtë veting, por po ashtu, ne si maxhorancë kemi marrë mjaft mbështetje në lidhje me gjithë angazhimin dhe përgjegjësinë tonë për ta çuar deri në fund reformën në drejtësi.

Do t'i drejtohesha opozitës dhe kryetarit të saj, për t'u thënë: mjaft më me këto manovra, të cilat i përdorni për t'i bërë edhe më konfuzë qytetarët, lidhur me çështjen se kush gënjen e kush thotë të vërtetën, kush është i korruptuar e kush jo. Por edhe shqiptarët duan shumë që në këtë vetingun tënd të hyjnë kunati, bashkëshorti, vjehri, djali apo vajza e kujtdo prej jush. Ne jemi gati që procesi i vetingut të kalojë në filtrë gjithsecilin prej nesh. Kjo është arsyeja pse luftuam për një sistem drejtësie të pakorruptuar, për një reformë që e kthen drejtësinë në të drejtë, gjë që e kemi treguar gjithë këto kohë.

Nërkohë që vëmendja jonë është çdo ditë e më shumë te njerëzit, Lulzimi zgjohet dhe mendon për hallin e vet.

Të dashur bashkëqytetarë,

Ky propozim i ardhur prej Lulzimit ka një qëllim thellësisht propagandistik, për një gjoja veting që bëhet nga vetë politikanët për politikanët, që nuk merret me pasurinë e politikanëve, as me familjarët e politikanëve, as me dënimin e politikanëve të korruptuar apo të lidhur me krimin.

Pas muajsh të tëra përpjekjesh për të ndaluar reformën në drejtësi, ngritjen e strukturave të posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, tani që institucionet kushtetuese janë në prag të nisjes së vetingut real të opozitës, opozita sjell këtë propozim propagandistik.

Ne jemi gati për veting, po për një veting të vërtetë. Nuk mund të bëhet veting në politikë nga vetë politika. Qytetarët e këtij vendi nuk duan, nuk kërkojnë e as nuk presin këtë. Kjo do të ishte qesharake. Qesharake dhe e pamundur edhe për vetë artikulatesit e tezës. Është vetëm një fasadë, që të vazhdojnë t'u hedhin hi syve këtij populli me tezën: ne jemi të gjithë njësoj.

Jo, ne nuk jemi të gjithë njësoj. Ne jemi për një drejtësi të pavarur e jo për drejtësi të posaçme për politikanët, domethënë për sojin tonë, sepse, zoti Basha, ne nuk jemi njësoj. Kjo është arsyeja pse e kemi mbështetur që ditën e parë reformën në drejtësi, ngritjen e SPAK-ut e të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pikërisht për të

hetuar, larguar dhe ndëshkuar politikanët e korruptuar e të lidhur me krimin.

Ne jemi gati të ulemi e të diskutojmë çdo lloj propozimi, me kushtin e vetëm që të mos ndalet reforma në drejtësi dhe ngritja e institucioneve të pavarura që do të realizojnë vetingun në politikë.

Ne jemi gati të përballemi me këtë sfidë, e cila është e vetmja që i bën qytetarët e këtij vendi të ndjehen besimplotë se ky vend po ndryshon.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bello!

Fjalën e ka zonja Mesi. Të përgatitet deputetja Antoneta Dhima.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

E nderuara kryetare e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, në themel të të gjitha vendimeve dhe propozimeve tona qëndron angazhimi dhe vullneti ynë i plotë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi, e sigurisht për të lehtësuar me sa të mundemi sipërmarrësit dhe klimën për investime.

Mendojmë se të dyja këto mënyra krijojnë një klimë të domosdoshme për zhvillimin ekonomik, rritjen e qëndrueshme ekonomike, përmirësojnë cilësinë e jetesës, mundësojnë zhvillim social dhe mirëqenie të shtuar.

Më lejoni t'i konkretizoj këto parime dhe propozime që diskutohen sot, por jo vetëm. Tashmë, gjatë mandatit të parë katërvjeçar dhe gjatë vitit të parë të këtij mandati, pra për pesë vjet, kemi propozuar dhe do të vazhdojmë të propozojmë reforma të cilat, nga ana strukturore do të lehtësojnë, do të përmirësojnë dhe do të nxisin sipërmarrjen e lirë.

Më lejoni t'ju bëj me dije të gjithëve, se projekti "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28, 12, 1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar", ka parashikuar veçse ndryshime në dispozita ekzistuese të ligjit, duke propozuar lehtësira fiskale të qenësishme.

Nga iniciativat tona për përmirësimin e incentivave fiskale, vlen të përmenden të mëposhtmet: reduktimi i shkallëve të tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20 % në 6 % do të aplikohet nga 20% në 6% do të aplikohet në shërbimet e akomodimit elitare në fushën e turizmit. Një reduktim të tillë të normës, në vlerën 6% të tatimit mbi vlerën e shtuar, do ta kenë edhe strukturat, të cilat do të zhvillojnë veprimtari

mirëprirëse të certifikuara si agroturizëm. Kjo do të vlejë jo vetëm për furnizimin e shërbimit të akomodimit, por edhe të restorantit.

Për personat juridikë, të cilët e ushtrojnë aktivitetin në prodhim dhe zhvillim të softuerëve, tatimi i fitimit do të jetë 5%. Besoj se teknologjia e informacionit dhe inovacioni janë e ardhmja e zhvillimit ekonomik të vendit, kështu që do të rrisim sipërmarrësit dhe të rinjtë e talentuar në këtë fushë. Për personat juridikë, të cilët e zhvillojnë veprimtarinë ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, shkalla e tatimit nga 15% është ulur në 5%. Kjo sepse jemi të bindur që bashkimi i të gjitha strukturave bujqësore, fermerëve dhe blegtorëve, jo vetëm do të rrisë ekonominë, jo vetëm do të përfitojë nga ekonomia e shkallës, por është jetike dhe shumë e rëndësishme për të thithur edhe fondet e Bashkimit European në këtë segment.

Ulja e tatimit për bizneset e vogla dhe të mesme me xhiro deri në 14 milionë lekë të rinj në vit nga 15% do të bëhet 5%.

Së dyti, për sa i takon dekretit të Presidentit, të cilin e kemi edhe sot në shqyrtim, dua të theksoj edhe një herë se nuk bëhet fjalë për ulje të vlerës së tatimit mbi fitimin, përkundrazi te 15%-shi, që është standard për të gjithë, do të hyjë edhe Lotaria Kombëtare, e cila më parë tatohej me 10%.

Nëse flasim për numrin e kompanive, të cilat e ushtrojnë aktivitetin me lojërat e fatit, viti 2013 shënonte diku te 40 licenca për këto aktivitete. Sot, në vitin 2018, ne kemi një përgjysmim të këtyre licencave dhe, për më tepër, nga janari i vitit 2019 kazinotë do të zhvendosen në zona të pabanuara, në periferitë e qyteteve, duke ruajtur edhe distancën prej 200 metrash nga njëra-tjetra. Këtu ftoj të gjitha agjencitë, të cilat janë të ngarkuara për monitorimin e këtij ligji, ta zbatojnë atë me përpikëri. Pra, masa të tilla, të cilat përmirësojnë klimën e biznesit dhe ekonominë shqiptare, janë dhe do të vazhdojnë të ngelen prioritet i qeverisë.

Ekonomia e Shqipërisë në pjesën e parë të vitit 2018 tregoi sërish rritje pozitive, prodhimi i brendshëm bruto real u rrit në normën 4,45% në tremujorin e parë të këtij viti, krahasuar me 3,84% që shënonte në fund të vitit 2017, duke vazhduar trendin 4-vjeçar tashmë, që prej vitit 2014, të përshpejtimit të rritjes ekonomike.

Dua të theksoj se politikat tona fiskale gjatë viteve të ardhshme do të vazhdojnë të mbështesin lehtësimin e sipërmarrjes dhe garantimin e rritjes së qëndrueshme që në fund prodhon atë që duam: punësim real.

Buxheti dhe politikat e qeverisë do të kenë gjithmonë në qendër qytetarin, rritjen e mirëqenies, rritjen ekonomike, rritjen e aksesit drejt shërbimeve dhe drejt cilësisë jo vetëm në kryeqytet, por edhe në skajet më të largëta të vendit. Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit është i pashkëputur nga reformat e tjera madhore, sikurse është edhe reforma në drejtësi. Ndërkohë që qeveria dhe Kuvendi, pjesa e maxhorancës, vazhdojnë të jetë të përqendruara te njerëzit dhe te reformat që do të përmirësojnë jetën e tyre, te reformat dhe kryereformat, siç është edhe reforma në drejtësi apo ngritja e organeve, si SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, opozita ka hallin e saj personal, në përpjekje për t'i shpëtuar skanerit të këtyre institucioneve. Pa dyshim, përgjigjja jonë është thellimi i reformës në drejtësi, ngritja dhe funksionimi i SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kjo nismë e opozitës për veting në politikë është një marifet për t'iu shmangur reformës në drejtësi. Ndërkohë, SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit sigurojnë vetingun e politikës në shkallë shumë më të gjerë. Këto dy institucione nuk kalojnë në sitë thjesht lidhjet e politikanëve me krimin, por, mbi të gjitha, pasuritë dhe të ardhurat e tyre. Këto dy institucione nuk ndalojnë vetëm te politikanët, por edhe te pasuria dhe tek të ardhurat e familjarëve të tyre. SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit nuk mjaftohen vetëm me largimin e politikanëve të lidhur me krimin, por garantojnë që të merren masa ndëshkuese deri në burgim të politikanëve të korruptuar dhe të lidhur me krimin. Përmes SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit vetingu i politikës do të bëhet jo vetëm nga politikanët dhe të zgjedhurit e tyre, por do të bëhet dhe duhet të bëhet edhe nga organet kompetente të pavarura të drejtësisë, sigurisht, institucionet kushtetuese, nën monitorimin e Bashkimit të European dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ne jemi gati për veting, por për vetingun e vërtetë, prandaj e kemi mbështetur reformën e drejtësisë që nga dita e parë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë deri në ngritjen e të gjitha strukturave, me qëllim që

infrastruktura e reformës në drejtësi të marrë jetë në formën e saj definitive. Reforma në drejtësi jep 100% garanci për veting real, por, sidoqoftë, jemi gati të ulemi me opozitën për të diskutuar çdo lloj propozimi, por asnjëherë të mospranojmë kompromis në lidhje me cedimin e një elementi të vogël në lidhje me reformën në drejtësi, pasi jemi të bindur që reforma në drejtësi ngritja e të gjitha institucioneve të saj, jo vetëm do të bëjnë vetingun e politikës, por do të bëjnë vetingun e gjithë atyre që kanë përfutur edhe nga politika.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

Të përgatitet deputeti Roland Xhelili.

Antoneta Dhima - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Të dashur qytetarë,

Parlamenti e filloi sesionin e ri dhe për të gjithë ne deputetët kjo është një fazë e re, prandaj duhet impenjim maksimal dhe energji për të përmbyllur të gjitha reformat për të qenë pjesë e Bashkimit European. Ndiej keqardhje që opozita, në vend të debatit politik në sallën e Kuvendit, ka zgjedhur një tjetër rrugë, atë rrugë, që, në fakt, nuk të çon askund. Secili prej nesh duhet të marrë përgjegjësinë që i takon brenda kësaj sale, pavarësisht nëse është në opozitë apo në maxhorancë.

Ndiej keqardhje që deputetët e opozitës kanë zgjedhur rrugën e bojkotit të seancave parlamentare, ku diskutohen shumë ligje, madje edhe ato për të cilat opozita ka bërë shumë zhurmë, madje në disa raste ka zhvilluar edhe aksione politike. Edhe në rastin e vetingut të politikës opozita duhej të ishte në këtë sallë për të diskutuar rreth kësaj çështjeje, si dhe të jepte mendimet, opsionet e saj për vetingun në drejtësi, që po ecën me ritmet e duhura. Këto qëndrime politike nuk i japin asnjë pikë opozitës, pasi deputetët e opozitës janë votuar për të bërë politikën e tyre brenda institucioneve dhe jo në takime elektorale. Ligjet që presim të votohen nuk janë të Partisë Socialiste, por u shërbejnë qytetarëve, ndaj kjo duhet të jetë kryefjala e punës së këtij parlamenti dhe e deputetëve të zgjedhur. Kjo situatë politike nuk i shërben askujt. Ne të gjithë kemi përgjegjësi për të mirën e shqiptarëve, duke përfshirë këtu edhe deputetët e opozitës. Ka ardhur koha që opozita të jetë e

përgjegjshme; ka ardhur koha të heqim dorë nga politika e interesave të vogla dhe të mendojmë seriozisht për sfidat që na presin në të mirë të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ne apelojmë për bashkëpunim. Kjo është artikuluar nga të gjithë krerët e lartë të Partisë Socialiste dhe nga vetë Kryeministri Rama, ndërsa nga opozita nuk ka pasur asnjë reagim. Jemi përballë sfidave, për të cilat kemi detyrimin të bëjmë më të mirën, sepse vetëm kështu koha do ta në vlerësojë dhe shqiptarët vetë do të dinë të na vlerësojnë.

Kthimi i ligjit nga ana e Presidentit të Republikës është mbështetur kryesisht në dy elemente: iniciativa nuk i përmbush objektivat sociale të shtetit shqiptar, që janë të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës; ndryshimet e propozuara janë të paargumentuara nga ana ekonomike dhe kanë sjellë një reduktim të barrës fiskale nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për biznesin e lojërave të fatit.

Duke u bërë një analizë të përgjithshme pretendimeve të ngritura nga Presidenti i Republikës, rezulton se pretendimi për mospërmbushjen e objektivave sociale të përcaktuara në Kushtetutë nuk është i bazuar, pasi shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në mbështetje të nismës dhe përgjegjësisë private, synon: punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave që janë të aftë për punë; plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim; një standard më të lartë shëndetësor, fizik dhe mendor; arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve, të rinjve dhe të personave të papunësuar; përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; zhvillimin e sportit dhe veprimtarive ripërtëritëse.

Argumentet e paraqitura nga Presidenti nuk mund të jenë të lidhura me ligjin për tatimin mbi të ardhurat, i cili është një ligj organik që rregullon marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin, si dhe tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave, por mund të kishte qenë objekt vlerësimi gjatë miratimit të ligjit organik që rregullon lojërat e fatit.

Argumentin e Presidentit se ndryshimet e propozuara janë të paargumentuara nga ana ekonomike dhe se ka reduktim të barrës fiskale për shkak të aplikimit të sistemit të ri të tatimit

për bizneset e lojërave të fatit nëpërmjet përdorimit të konceptit “të ardhura bruto” dhe jo “xhiro vjetore” e konsideroj jo të drejtë, pasi rregullimi i marrëdhënieve, që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin dhe tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave bëhet nëpërmjet ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për taksimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”. Pra, ligji organik, që rregullon tatimin mbi të ardhurat, në frymën e tij ka përcaktuar se baza e taksueshme është e ardhura dhe jo xhiroja. Ndryshimet sipas nenit 6 të ligjit nr. 39/2018 nuk e kanë ulur nivelin e taksimit për lojërat e fatit. Ky nivel ishte dhe mbetet 15% mbi të ardhurat bruto. Ndryshimi konsiston në unifikimin e nivelit të tatimit edhe për Lotarinë Kombëtare, e cila përjashtohet nga ky ligj, duke e çuar atë nga 10% të xhiros në 15% të të ardhurave bruto. Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, i cili është miratuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe në këtë Kuvend nuk ka të bëjë me lojërat e fatit. Ligji në mënyrë të qartë ka të bëjë me uljen e tatimit të fitimit për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë një xhiro nga 2 milionë në 14 milionë lekë dhe një tatim mbi fitimin nga 15% në 5%. Ligji ka pasur në fokus të tij agroturizmin dhe që nga 1 janari këto biznese do të favorizohen haptazi në veprimtarinë e tyre nëpërmjet favorit fiskal që kjo maxhorancë u ka dhënë në këtë ligj të posaçëm. Ligji ka pasur si fokus të veçantë kooperimin, me qëllim rritjen e produktivitetit në bujqësi dhe në blegtori, pra ka pasur në fokus të qartë fshatin, duke i favorizuar këto aktivitete me uljen e tatimit nga 15% në 5%. Nuk ka ulje të normës së tatimit për lojërat e fatit. Ky definicion i vendosur në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” nga ne është i njëjtë me atë që është vendosur në ligjin për lojërat e fatit që në vitin 2015.

Për sa diskutova më lart, mendoj se argumentet e paraqitura në dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nuk qëndrojnë dhe, në këto kushte, të nderuar kolegë, ju ftoj të mos e miratojmë atë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka deputeti Roland Xhelilaj.

Të përgatitet deputetja Ermonela Felaj.

Roland Xhelilaj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot në seancën plenare kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 1850. Që në fillim dua të theksoj se dekreti ka vetëm një qëllim: të shtyjë hyrjen në fuqi të ligjit nr. 39/2018, i miratuar në seancën e datës 9 korrik të këtij viti. Kjo është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar. Në dekret, “për të sensibilizuar opinionin qytetar”, neni 6 trajtohet me lojëra fjalësh, duke përdorur termin “bixhoz”. Ky nen, brenda këtij ligji përgjithësisht pozitiv, shprehje që del me vështirësi nga relacioni i Presidencës, bëka uljen e barrës fiskale tatimore për biznesin e lojërave të fatit, pra ndihmon njerëz të lidhur me pushtetin! Kaq mjafton për t'i lënë hapësirë imagjinatës së qytetarit të painformuar, edhe me ndihmën e opinionbërësve të caktuar, për të krijuar dyshime.

Para se të ndalem shkurtimisht në disa masa që do të merren në vazhdimësi, edhe si detyrim i ligjit që kemi miratuar, dua të nënvizoj një situatë të çuditshme. Presidenti rikthen ligjin për shqyrtim në Kuvend, duke nënvizuar problemet që mbart e sjell ligji, sipas tij dhe opozitës. Në përputhje me detyrimet dhe funksionet e Kuvendit, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, por edhe seanca plenare e sotme, bën shqyrtimin serioz të tij, por si në komision, edhe sot në seancë, për fat të keq opozita, Partia Demokratike dhe LSI-ja nuk marrin pjesë. Që nga nisja e sesionit të ri parlamentar adresa e tyre është drejtimi i paditur.

Të nderuar qytetarë,

Mungesa e opozitës në parlament lidhet sot edhe me mungesën e argumenteve ndaj këtij dekreti, megjithatë në respekt ndaj jush dhe të parafolësit, më lejoni të trajtoj disa probleme që lidhen me këtë dekret.

Shkurtimisht, në dekret thuhet: “Neni 6 i ligjit nr. 39/2018 parashikon ndryshimin e paragrafit të 2, të pikës 7, të nenit 38 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me këtë përmbajtje: “Tatimi mbi lojërat e fatit sipas nenit 52.2 të ligjit nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” aplikohet në shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga lojërat për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit përfshirë edhe Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr.

95/2013. E ardhura bruto nga lojërat është shuma e mbetur e organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin, llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Pra, si ka qenë, po përsëri sipas relacionit thuhet: “Të ardhurat e organizatave të lojërave të fatit taten me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit të ligjeve respektive, pra të ligjit nr. 155/2015 dhe të ligjit nr. 95/2013, që ka të bëjë me Lotarinë Kombëtare”. Ku qëndron ndryshimi?

Po, kemi një ndryshim. Barra tatimore për Lotarinë Kombëtare si për çdo lloj loje tjetër të fatit në listën e lojërave ndryshon, sepse tatim fitimi, që ishte 15%, bëhet 10%. Lehtësimi i kompanive që merren me lojërat e fatit paska qenë i lidhur me Lotarinë Kombëtare ose ka formula të reja, të cilat tatimin 15% e konsiderojnë më të vogël se 10%-i. Ky është qëndrimi i Partisë Demokratike, e cila në periudhën e drejtimit nga ana e saj lejoi lulëzimin e pakontrolluar të këtyre kompanive. Me normën magjike të tatim fitimit prej 10% numri i kompanive të lojërave të fatit në fund të vitit 2013 arriti në 40, sot janë vetëm 20, pra kemi një reduktim prej 50% të tyre dhe gjatë kësaj periudhe kemi mosdhënien e asnjë licence të re apo mjeti sekondar për lojërat e fatit.

Pra, problemi nuk është barra tatimore. Për ne dhe për qytetarët problemi është zbatimi i vendimit të marrë me urdhër të Kryeministrit për zhvendosjen e kazinove dhe të lojërave elektronike nga qendrat e banuara në qytet dhe në fshat në zonat periferike të përcaktuara. Krahas vlerës së barrës tatimore kjo masë që kërkon mbështetjen e të gjitha forcave politike, pasi të qytetarëve e ka pasur me kohë, besoj se e tremb opozitën. E rëndësishme për ne është vendosmëria e institucioneve të ngarkuara me këtë detyrë për realizimin e objektivit, që fillimi i vitit 2019 të lirojë qendrat e banuara nga këto aktivitete. Kjo është përgjigjja më e mirë për këdo që mundohet të kërkojë dhe të nënvlerësojë arritjet e qeverisë “Rama”.

Të nderuar kolegë,

Ndryshimet e propozuara nga qeveria “Rama” në ligjin nr. 39/2018 janë pjesë e implementimit të paketës së re fiskale në mbështetje të vazhdueshme ndaj sipërmarrjes

private, garantimit dhe rritjes së saj të qëndrueshme dhe ndikimit pozitiv në rritjen e të punësuarve në këto aktivitete. Ligji nr. 39/2018 përbëhet nga 8 nene. Në dekretin e Presidentit, duke u marrë në mënyrë jo korrekte vetëm me nenin 6, u arrit të shtyhet përfitimi i lehtësimit të barrës fiskale që redukton normën e tatim fitimit nga 15% në 5% për biznesin e vogël dhe të mesëm, për fermerët dhe për bizneset që operojnë në fushën e agroturizmit.

Më lejoni t’ju nënvizoj disa të dhëna për periudhën qershor-gusht, të Drejtorisë së Tatimeve në Durrës.

Të ardhurat totale për këtë periudhë u tejkaluan 11% krahasuar me planin dhe 16% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shitjet me TVSH 20% u rritën 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ndërsa shitjet me 6%, akomodimi në hoteleri, u rritën me 40%. Xhiroja e deklaruar nga kasa fiskale për këtë periudhë ka një rritje 14% dhe numri i kuponëve të lëshuar ka një rritje 24%.

Janë kryer 524 njësimet e reja gjatë periudhës qershor-gusht, janë riaktivizuar 342 tatim-pagues gjatë këtij sezoni. Sot në Durrës janë regjistruar 3 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e agroturizmit dhe janë në proces licencimi edhe 3 të tjera.

Është e rëndësishme të nënvizoj faktin se punësimet e reja gjatë sezonit turistik për Drejtorinë Rajonale Durrës ishin 7657 punonjës. Pra, qytetarët punojnë, bizneset janë në aktivitet, ndikimi pozitiv i paketave fiskale lehtësuese të qeverisë në bujqësi, turizëm e në vende të tjera po sjellin rezultate në rritje. Edhe ligji nr. 39/2018 është një ndihmë dhe detyrim yni për njerëzit e punës, ndaj rrëzimi i dekretit të Presidentit i hap rrugën hyrjes në fuqi të tij.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Xhelili!

Këtu mbylлим diskutimet për dekretin.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar”. Sipas nenit 73, paragrafi i dytë i Rregullores, të nderuar kolegë, keni të drejtë të bëni pyetje për projektligjin.

Nismëtarë të këtij projektligji janë Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

A ka pyetje? Nuk ka.

Kalojmë në paraqitjen e projektligjit nga nismëtarët. Një nga ministrat ka të drejtë, nëse dëshiron, të bëjë paraqitjen e projektligjit.

A dëshirojnë ministrat ta paraqesin projektligjin?

Po, zoti Ahmetaj.

Fjalën e ka zoti Ahmetaj pa kufizim kohe.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Shumë shkurt do t'ju flas për ligjin e ish-të përndjekurve, duke iu referuar vetëm thelbit të ndryshimeve. Para se të vijmë te ndryshimet, dua t'ju bëj të ditur disa statistika, të cilat i konsideroj të rëndësishme për të parë, për të ndjerë dhe për të prekur atë vëmendje që kanë treguar forcat politike ndër vite ndaj kësaj kategorie.

Përgjatë harkut kohor 2009-2018 janë miratuar rreth 13 mijë e 101 dosje të aplikuara nga ish-të përndjekurit politikë. Ndërkohë, në retrospektivë financiare, praktikisht janë shpërndarë deri tani 8 këste për kategorinë parësore. Për shkak të kufizimeve ligjore të kësteve jo më i madh se 1 milion dhe jo më i vogël se 100 mijë, ka dalë domosdoshmëria e ndërhyrjes në ligj për të bërë të mundur dhënien e kështit të nëntë për një pjesë të kësaj kategorie, të cilët, për shkak të madhësisë dhe kufizimit të kësteve, nuk kanë arritur të marrin atë që u takon, që do të thotë se kështit i nëntë do të bëjë të mundur mbylljen e pagesës së dëmshpërblimit të kategorisë parësore. Janë rreth 1200 dosje parësore dhe joparësore që do të përfitojnë nga ky ndryshim ligjor.

Siç e theksova me kështin e nëntë do të mbyllem të gjithë pjesën e kategorisë parësore, ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin. Ka pasur një debat të gjatë, edhe brenda parlamentit, për sa i përket çështjes se çfarë ka ndodhur me ish-të përndjekurit politikë dhe unë dua të ndaj me ju disa shifra të rëndësishme, që, fatkeqësisht, Partia Demokratike i ka përdorur vetëm për efekte elektorale edhe për këtë kategori.

Po të vini re, në vitet elektorale shifrat rriten dhe pas kësaj ato bien në minimume historike. Që nga viti 2010 deri në vitin 2014

janë shpërndarë 7,9 miliardë lekë. Që nga viti 2014 deri në vitin 2018, në 4 vjet të qeverisë “Rama”, janë shpërndarë 9,1 miliardë lekë. Këto janë shifra fare të thjeshta, pra 79 milionë dollarë njëra forcë politike dhe 91 milionë dollarë qeveria “Rama”. Këtu dallohet drejtpërsëdrejti se çfarë vëmendjeje ka pasur njëra parti, njëra maxhorancë, një qeveri, me partinë, maxhorancën apo qeverinë e dikurshme. Gjithë debati, këta komunistët, këta që na mbështetën, këta demokratët, kthehet në debat qesharak, sepse shifrat flasin vetë.

Do t'ju sjell një shembull tjetër për sa i përket kategorisë së parësorëve: sipas këtyre i paskan dhënë gjithë kësaj kategorie parësore, atyre që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin, dëmshpërblim 70 milionë dollarë. Këtë shumë kanë marrë ish-të përndjekurit, ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti, nga maxhoranca e majtë në këta 4 vjet. Ndërsa nga këta demokratët, që i paskan mbështetur “emocionalisht” ndër vite, ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti, kanë marrë vetëm 15 milionë dollarë. Janë shifra të verifikueshme. E kuptoj shumë mirë që dikush mund të jetë i emocionuar dhe të më kthehet mua apo qeverisë (të na thonë siç e kanë zakon ata të djathtët ekstremë, që me demokracinë vlerat e së djathtës “ekstreme”): “Ore, ju, pinjollë të komunistëve, me kë talleni?!”. Unë me modesti dhe me vëmendjen ndaj vuajtjes që ka pësuar kategoria parësore, u them: “Ne, qeveritë e majta, e konsiderojmë këtë kategori si një nga të gjitha kategoritë e qytetarëve, këtë kategori nuk e konsiderojmë si falangë politike. Jo, ne nuk bëjmë dallim midis veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe ish-të përndjekurve! Ne i trajtojmë si dy kategori që kanë nevojë për vëmendje si qytetarë të këtij vendi!”.

Fakti statistikor i trajtimit ka mbrapa drejtpërsëdrejti vëmendjen ndaj qytetarëve. Kjo maxhorancë e majtë ka dhënë 70 milionë dollarë për kategorinë parësore dhe maxhoranca e dikurshme, me demokracinë përfaqësuese e vlerave të djathta, i ka dhënë vetëm 15 milionë dollarë, pra e ka përdorur si kontingjent politik elektorale. Jo, ne i shohim si qytetarë, si një kategori që ka vuajtur në regjimin komunist, që meriton vëmendje dhe kjo vëmendje është materializuar. Po në këtë ndryshim ligjor materializohet një vëmendje e mëtejshme ndaj këtyre qytetarëve, duke bërë të mundur mbylljen e pagesës së

dëmshpërblimit për kategoritë parësore, që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dhe do të vazhdojmë me pagesën për trashëgimtarët. Këtu kemi hequr edhe atë kushtin, raportin midis 70 dhe 30, për të bërë të mundur pagesën më fleksibël ndër vite. Mendohet që ndër vite të paguajnë gati 490 milionë dollarë për kategorinë e ish-të përndjekurve politikë. Pra, minimalisht me përllogaritjet tona shkon rreth 500 milionë dollarë, përveç shumave që u janë paguar në 2 forma kryesore: në kesh dhe në avancim, privatizimi me bono privatizimi, ku shuma vetëm për këtë kategori të fundit shkon gati 34 milionë dollarë. Duke i mbledhur bashkë të gjitha shumat që ka përfituar kategoria e ish-të përndjekurve, ato shkojnë mbi 220 milionë dollarë në vitet e fundit.

Këtu do ta mbyll diskutimin tim. I kërkoj Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste t'i votojë ndryshimet, të cilat janë të domosdoshme për të përshpejtuar pagesën e dëmshpërblimit ndaj kategorisë së ish- të përndjekurve politikë, që ne i shikojmë si qytetarë, të cilët kanë nevojë për vëmendjen e qeverisë, ndërsa ata i kanë parë në vazhdimësi jo si qytetarë, por thjesht si kontingjentin e tyre politik dhe elektorat.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Zonja Ministre e Drejtësisë, dëshironi ta merrni fjalën tani apo më pas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pas.

Atëherë, sipas Rregullores, neni 74, ka të drejtë të shprehet komisioni përgjegjës, i cili është Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Zonja Kushi, ju keni fjalën edhe në emër të grupit. Do të flisni tani apo në emër të grupit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në emër të grupit.

Faleminderit!

Kalojmë në diskutimet e deputetëve të regjistruar më parë. Për këtë projektligj janë regjistruar deputetët: Xhevit Bushaj dhe Vullnet Sinaj. Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së është regjistruar deputetja Evis Kushi. Fjalën e ka deputeti Bushaj.

Xhevit Bushaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në këtë seancë plenare po diskutojmë për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish- të dënuarve politikë të regjimit komunist”. Qëllimi i këtij projektligji është mundësimi i të drejtës ligjore që gëzojnë ish- të përndjekurit e regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë dhe bëjnë pjesë në kategorinë parësore, që të përfitojnë të gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit financiar, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet përshpejtimi i procesit të dëmshpërblimit financiar për familjet e viktimave të burgosura, të ekzekutuara dhe të internuara. Ashtu sikurse edhe ligjet e mëparshme amenduese të ligjit nr.9831 të vitit 2007, të ndryshuara, edhe ky projektligj synon mbylljen e procesit të dëmshpërblimit për ish -të dënuarit që e kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, si dhe familjarëve të tyre nëpërmjet gjetjes së mekanizmave më eficientë.

Të nderuar kolegë, dua të them diçka për zotërinjtë e opozitës që mungojnë në këtë sallë dhe vazhdojnë të bëjnë propagandë, të mbajnë peng këtë shtresë të qytetarisë dhe të popullsisë sonë duke iu referuar, por duke mos ju lodhur, shifra që sapo përmendi ministri i Financave dhe Ekonomisë, të cilin gjej rastin ta falënderoj për këto shifra, qoftë edhe për ekspozenë që bëri në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, qoftë edhe sot. Po t'u referohemi shifrave dhe fakteve që vijnë për këtë shtresë në qeverisjen e PD-së janë shpërndarë vetëm 7,9 miliardë lekë, kurse në qeverisjen e PS-së janë shpërndarë 9,1 miliardë lekë ose duke futur të gjithë strukturat e kësaj shtrese parësore në harkun kohor të këtyre viteve nga ana e qeverisjeve të PD-së janë dëmshpërblyer me 15 milionë dollarë, kurse nga qeveritë e PS-së janë dëmshpërblyer me 90 milionë dollarë.

Zotërinj të opozitës, të nderuar kolegë deputetë të opozitës, ku është përkrahja e kësaj shtrese të shoqërisë sonë e këtyre njerëzve, që kërkojnë përkrahje dhe i trumbetoni dhe i përdorni si kontingjent sa herë që keni nevojë?

Projektligji synon përmirësimin e formulës së dëmshpërblimit financiar të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist për të siguruar një mbështetje më të mirë financiare për personat që

kanë vuajtur dënimin dhe janë ende në jetë, por edhe për familjarët e tyre, si dhe për të përshpejtuar dhe për të përfunduar sa më parë këtë proces.

Ky projektligj synon të realizojë një ndër objektivat e programit të qeverisë, i cili u kushton një vëmendje të veçantë ish- të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre. Programi parashikon përfundimin e dëmshpërblimit të kësaj kategorie gjatë mandatit të dytë të kësaj qeverie, si dhe mbështet integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre në çështjet shoqërore, ekonomike dhe politike.

Buxheti i vitit 2018 siguron mbështetjen e nevojshme financiare për dëmshpërblimin e ish- të përndjekurve politikë.

Projektligji parashikon një sërë ndryshimesh në ligjin ekzistues. Rishikon mekanizmin e shpërndarjes së fondeve, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të ish - të dënuarve politikë, që janë ende në jetë, si dhe subjekteve të tjera të kategorisë parësore. Sipas ligjit ekzistues, masa e dëmshpërblimit ndahet në mënyrë proporcionale, me një raport prej 70 % për subjektin përfitues parësor, bashkëshortin dhe fëmijët dhe 30 % për trashëgimtarët e tjerë, prindërit, vëllezërit, motrat dhe fëmijët e tyre.

Familjarët në shkallë të parë përjashtoheshin nga familjarët e tjerë. Projektligji i ri i heq këto raporte dhe parashikon që dëmshpërblimi të ndahet në mënyrë proporcionale midis të gjithë përfituesve.

Gjithashtu, në ligjin ekzistues theksohet se kësti i dëmshpërblimit duhet të jetë jo më i vogël se 100 mijë lekë dhe jo më i madh se 1 milion lekë. Projektligji heq kufirin e poshtëm prej 100 mijë lekësh. Në këtë projektligj dëmshpërblimi për subjektet parësore është realizuar në masën 90 % dhe mbetet e palikuiduar vetëm një diferencë e vogël.

Masat që propozohen në këtë projektligj do të sjellin ritme më të shpejta në shpërndarjen e dëmshpërblimit dhe në mbylljen e këtij procesi. Krijohet një mundësi tjetër, që të gjitha subjektet përfituese parësore, të cilave u takon një vlerë totale dëmshpërblimi mbi 8 milionë lekë, ta përfitojnë të gjithë shumën e dëmshpërblimit. Sipas ligjit ekzistues këto subjekte kufizoheshin. Dëmshpërblimi deri në 8 milionë lekë, tetë kështe me nga 1 milion lekë.

Projektligji parashikon vijimin e shpërndarjes së kësteve të dëmshpërblimit deri në shpërndarjen e plotë të tij. Gjithashtu, krijohet mundësia që, nëse vlera totale e dëmshpërblimit të miratuar për të gjithë përfituesit është 1 milion lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit të kryhet e plotë dhe me një kësht të vetëm.

Pikë tjetër është se dëmshpërblimi financiar ndërpritet me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë. Në këtë rast, duke qenë se dëmshpërblimi është një e drejtë parësore jovetiake dhe nuk zbatohen dispozitat e Kodit Civil, masa e dëmshpërblimit derdhet në buxhetin e shtetit.

Ky rregullim ligjor qartëson procesin e dëmshpërblimit dhe ndikon në përdorimin me ekonomi, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, gjë që është edhe një ndër parimet e sistemit buxhetor.

Së fundi, do të doja të theksoja se krijohet mundësia që, në rast gabimesh në llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, të bëhen korrigjimet e nevojshme nga organet kompetente.

Ndryshimet në këtë ligj nuk sjellin efekte financiare në buxhetin e shtetit. Do të doja të theksoja se masat e propozuara me këtë projektligj do të ndihmojnë në përfundimin më të shpejtë e më të plotë të dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë, duke qenë në të njëjtën linjë me objektivat e programit qeveritar dhe detyrimet e përcaktuara në ligjet e buxhetit 2018.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushaj!

Fjalën e ka deputeti Vullnet Sinaj.

Vullnet Sinaj – Të nderuar kolegë,

Të nderuar shqiptarë që na ndiqni,

Të nderuar ju ish-të përndjekur politikë, të dënuar nga regjimi i mëparshëm komunist,

Sot që diskutojmë këtë ligj është e papranueshme që pjesa e Partisë Demokratike, pjesa e deputetëve të Partisë Demokratike, t'i lërë bosh këto karrige, ndërkohë që vite me radhë ata e kanë përdorur kauzën tuaj të dëmshpërblimit për të marrë vota. Është turp i madh që ata nuk marrin pjesë në këtë seancë, por kanë ikur nga sytë këmbët për t'u ruajtur nga vetingu që po bëhet në drejtësi, duke na tundur kartën e gjoja vetingut në politikë.

Ejani, bujrrëm këtu, që ta bëjmë, kur të doni, edhe vetë në politikë!

Ky ligj, i cili ka të bëjë me disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9831 të datës 12.11.2007, është një ligj që ka si qëllim likuidimin total të ish-të përndjekurve e të dënuarve politikë nga regjimi komunist, të pjesës së tyre parësore, që janë të gjithë ata që jetojnë, por edhe të pjesëtarëve e anëtarëve të familjeve të atyre që nuk jetojnë. Pra, ka si qëllim likuidimin total të tyre. Mua më vjen mirë që jemi ne, pjesa e maxhorancës, deputetë të Partisë Socialiste, që po u japim këtë lajm dhe po marrim këtë vendim kaq të rëndësishëm në lidhje me likuidimin total të detyrimeve dhe dëmshpërblimeve për këta ish-të përndjekur.

Për të kuptuar se cila është diferenca ndërmjet deputetëve të maxhorancës dhe Partisë Demokratike, duhet parë kronologjia e zhvillimit të këtij ligji.

Ligji e ka zanafillën e vet në vitin 2007, kur ishte në qeverisje Partia Demokratike, e cila deri në 2009-ën nuk bëri asgjë. Më 2009 bëri vetëm një ndryshim në ligj: nga një shpërndarje e barabartë e dëmshpërblimit, në një shpërndarje proporcionale.

Nga 2009-a deri në 2012-ën nuk bëri asnjë veprim tjetër. Në vitin 2011 vijnë me një vendim të Këshillit të Ministrave të asaj kohe, të qeverisë së drejtuar nga zoti Berisha, në pikën 2 të të cilit thuhet se për shpërbimin e të dënuarve politikë që kanë vuajtur nga regjimi komunist, në çdo rast kësti i dëmshpërblimit është jo më i vogël se 100 mijë lekë dhe jo më i madh se 1 milion lekë. Në pikën 4 thuhet: “Dëmshpërblimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave ndahet në tetë kështe të barabarta.”

E kërkova fjalën për të folur, sepse dua të sqaroj njerëzit që më kanë takuar, ata njerëz që kanë vuajtur nga regjimi i mëparshëm komunist, që ishin të interesuar të merrnin dëmshpërblimet e tyre, por që shuma e vlerës së dëmshpërblimeve të të cilëve e kalonte shifrën prej 8 milionësh.

Unë do të doja t'i drejtoja një pyetje ish-Kryeministrit, njerëzve të Partisë Demokratike, deputetëve të tyre: pse është bërë ky kufizim, që të shpërndaheshin në tetë kështe? Po ata që kanë për të marrë më shumë se sa 8 milionë lekë, kur do t'i marrin ato lekë?

Prandaj jam sot këtu, për t'u thënë ish-të përndjekurve, ish-të dënuarve, se me këtë ligj që do të miratojmë sot, ata do të kenë të drejtën të marrin kështu e nëntë, pra për të marrë më shumë se sa 8 milionë, nëse u takojnë. Kjo mundësi u krijohet vetëm në sajë të maxhorancës, në sajë të qeverisë “Rama”.

Si ka mundësi që në kohën e qeverisjes “Berisha” është bërë ky gabim? Është gabim pa dashje, si gabimet e tjera matematikore që bëjnë këta apo është një gabim me dashje, për të thënë: ne nuk jua japim dëmshpërblimet që ju kanë mbetur nga dënimet e mëparshme.

Pas kësaj, në vitin 2014, me ligjin nr 94/2014 qeveria “Rama” bëri një ndryshim në ligj dhe, për t'i dhënë dëmshpërblimit të pjesës së ish-të dënuarve politikë që jetojnë, e ndau dëmshpërblimin në 70% për ata që jetojnë dhe 30 % për pasardhësit e atyre që nuk jetojnë më. Kjo solli si rezultat likuidimin e 90% të ish-të dënuarve nga qeveria “Rama”. Në një bisedë me një mikun tim të afërt të familjes, i cili ka vuajtur dënimin në sistemin e mëparshëm, kur e pyeta se çfarë mendimi kishte, më tha se në kohën e qeverisë “Berisha” kishin marrë vetëm 2 kështe, kurse në kohën e qeverisë “Rama” 6 kështe dhe ai vetë madje ishte i likuiduar. Miku im më tregoi edhe një fakt të çuditshëm, në vitin 2007 në çdo familje të ish-të dënuarve nga regjimi komunist qeveria “Berisha” kishte çuar nga një letër, ku iu kërkonte të tregonin sasinë e letrave me vlerë që kishin marrë. Imagjinoni, në atë kohë një pjesë e dëmshpërblimit të tyre është likuiduar me letra me vlerë dhe ne e dimë shumë mirë se vlera e atyre letrave shkoj në 6%. Nga ana tjetër, iu bënte një presion që, nëse nuk do të deklaroni të vërtetën, atëherë do t'u hiqte të drejtën e dëmshpërblimit. I frikësuar zotëria, mik i familjes sime, më thotë se kishte shkruar më tepër nga sa kishte marrë nga letrat me vlerë dhe sot gjendet me një kësht me pak të papaguar, por jo për fajin e qeverisë “Rama”, por për fajin e presionit që ushtroi qeveria “Berisha” ndaj këtij njeriu të nderuar, por që regjimi i mëparshëm e kishte dënuar. Ata na kanë krijuar mundësinë të jemi në këtë parlament dhe të flasim kështu të lirë, siç e mendojmë. Sot flasim të lirë dhe mbrojmë interesat e atyre që sakrifkuan jetën, sakrifkuan çdo gjë të tyre për të arritur në këtë ditë, por opozita nuk erdhi të marrë pjesë në këtë diskutim. Kjo është një tallje dhe ky është një

qëndrim që tregon se Partia Demokratike dhe deputetët e saj të gjithë kauzën që kanë tundur për interesat e ish- të dënuarve dhe të ish-të përndjekurve e kanë tundur kot, vetëm për interesat e tyre intelektuale.

Të nderuar qytetarë, duke parë këto karrige bosh, mendoni se kujt ia keni dhënë votën, mendoni si këta deputetë dhe si kjo opozitë nuk dihet ku ka vajtur, shkon dhe lëviz qyteteve për interesat e veta, për të mbrojtur secili pjesën e oborrit të vet, jo interesat tuaja, prandaj mendohuni mirë! Unë të isha në vendin tuaj asnjërin nga deputetët e opozitës, që kanë lënë këto karrige bosh, nuk do t'i votoja më, sepse nuk janë deputetë që mbrojnë interesat tuaja, por janë deputetë që mbrojnë vetëm interesat e veta.

Ky projektligj merr masa për likuidimin e plotë të dëmshpërblimit të ish- të përndjekurve politikë që jetojnë dhe të të afërmeve të tyre, ndryshon përsëri raportet nga 70% me 30% dhe krijon mundësinë e likuidimit total të ish- të përndjekurve. Kështu po bëjmë detyrën tonë si deputetë dhe si qytetarë për atë sakrificë që ata kanë bërë në kohën e regjimit komunist.

Për këto arsye do t'i jap një përgjigje një mikut tim, që u ankua se dëmshpërblimi i tij shkon deri në 1 milion lekë të rinj, por i ndjek kështu si ata që kanë më shumë se 8 milionë, me këtë projektligj, edhe nëse jeni në kështin e tretë, do t'ju paguhen menjëherë të gjitha kështet për të gjithë ju, ish- të përndjekur dhe të ish-të dënuar nga regjimi komunist, që keni për të marrë deri në shifrën 1 milion.

Gjithashtu, projektligji parashikon edhe korrigjimin e gabimeve që janë bërë në të kaluarën në përlogaritje ose ndonjë dokument. Pra, po krijohen të gjitha lehtësitë e mundshme për ta rehabilituar përfundimisht këtë pjesë të shoqërisë që u dhunua dhe u persekutua nga regjimi komunist, por jo pak edhe në këtë kohë të demokracisë nga Partia Demokratike dhe nga deputetët e saj.

Ju ftoj, të nderuar deputetë, ta votoni pa hezitim këtë projektligj, për t'u dhënë mundësinë e rehabilitimit kësaj pjese të nderuar të shoqërisë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka deputetja Elisa Spiropali.

Elisa Spiropali – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Shpreh keqardhjen e thellë që e shoh këtë sallë gjysmë bosh edhe pse, të them të drejtën, edhe kur ka qenë plot dukej sikur në këtë pjesë të sallës muret kanë veshë dhe veshët kanë mure.

E them këtë sepse dëgjojmë pafundësisht nga ish- kryeministri, nga drejtuesi aktual i partisë, por edhe nga eksponentë të tjerë që marrin nëpër gojë dhe flasin me një gjuhë të papërbalueshme gjithkënd dhe kurdo. “Hajdut, kriminel, vrasës, trafikant, ordiner, vagabond e të tjera”, me sa mbaj mend unë, në këta 27 vjet kanë qenë fjalët dominuese. I kanë bërë gjyqin gjithkujt pa pasur asnjë provë. E kanë uzurpuar politikën përmes denigrimit, përmes fyerjeve dhe përmes lodhjes së veshëve të publikut. Tani që vjen puna për t'i ndarë hesapet dhe për ta ndarë shapin nga sheqeri janë tërhequr, tani që organet kushtetuese si: Prokuroria e Posaçme, SPAK-u, BKH-ja më në fund do të ngrihen në këmbë, pas një procesi të plotë pastrimi të institucioneve të drejtësisë, kanë shpikur një hile të re, quhet “autoveting”, “vetëveting”, duan që politikanët në këtë sallë të bëjnë analizën e vetes, nëse janë të aftë apo të pa aftë, a janë lidhur me kriminelin ose jo. Përfytyroni një komision me kryetar Ervin Salianjin, me sekretar Klevis Balliun dhe Ed Palokën, me anëtarë Flamur Nokën Albana Vokshin dhe që t'u bëjnë gjyqin dhe vetingun Lulzim Bashës dhe gjithë të tjerëve.

A e përfytyroni dot ju, të dashur qytetarë, se këtu në të djathtë nuk kam se kujt t'i flas, prandaj po ju flas ju, se këta nuk duan që gjyqin, vetingun, analizën, ndarjen e shapit nga sheqeri, të na e bëjë ONM-ja apo SPAK-u, të cilat janë institucione të ngritura për këtë qëllim, nën vëzhgimin e rreptë të SHBA-ve, por duan që ta bëjnë vetë. Jo!

E dyta, thonë: “Jo, nuk duam të na hetohen familjarët!”

Ne e dimë se interesat e politikës janë të parkuara te familjarët. Pse nuk duan këta që ne t'i marrim dhe t'i shohim me radhë kunetërit, baxhanakët, vëllezërit, motrat, sojin e sorollopën, ku e kanë fisin me radhë? Pse?

Lulzim Basha u tërhoq sot nga propozimi i tij dhe tha se nuk ka punë me familjarët.

E treta, nuk duan që kur vetingu t'u nxjerrë të palarat, të shkojnë aty ku e kanë vendin, pra të hetohen deri në fund, për të parë nëse këta njerëz

janë për burg, apo jo. Ata thonë: “Jo, të bëjmë një komision të përbashkët, të biem dakord se cili do të jetë aty, sikur të jetë byroja e Partisë së Punës, dhe pastaj të shkojë secili në punën e tij.” Jo, nuk mund të shkojë në punën e tij, por duhet të shkojë aty ku e ka vendin.

E katërta, ata duan ta marrin, ta zhveshin, ta grisin reformën në drejtësi për ta marrë në duart e tyre. Kaq e thjeshtë është kjo histori.

Ata nuk duan që askush nga të lidhurit me ta të përfshihet këtu. Është qesharake, e papranueshme dhe tregon më së miri se tani, kur më në fund po ngrihen organet, kur vetingu në drejtësi po bën punën, duke larguar gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar, tani që ka ardhur koha që drejtësia të qëndrojë mbi të gjithë në këtë vend (edhe mbi politikanët), duan të shpikin komisionet e përbashkëta, ashtu siç kanë bërë për 27 vjet tranzicion, kur politikanët uleshin dhe vendosnin se kush do të ishte prokurori, kë do të zgjidhnin në KLSH, se si do t'i ndanin hesapet me njëri-tjetrin tek ILDKPI-ja etj. Pra, politika vendoste pazarin.

Me ndryshimet kushtetuese që janë bërë para 2 vjetësh dhe janë votuar këtu, raporti ka ndryshuar dhe është përmbytur. Tashmë politika ka vendin e saj për të bërë ligje të mira dhe politika për njerëzit, ndërsa drejtësia ka vendin e saj. Më në fund njerëzit do të munden të ndajnë të mirën nga e keqja dhe do të shohin se cilët politikanë e kanë vëmendjen tek ta e janë duke punuar për ta dhe cilët politikanë e kanë vëmendjen për të krijuar mjegull edhe aty ku nuk ka.

Më në fund kjo mjegull po shpërbëhet. Sistemi i drejtësisë po pastrohet. Më në fund kemi partnerë, që na besojnë në këtë proces. Jemi përpara fillimit të negociimit për kapitujt me BE-në.

Ja ku është rezultati, duan ta minojnë deri në fund edhe reformën në drejtësi, edhe procesin e integritetit të Shqipërisë në BE, por rruga e integritetit të Shqipërisë drejt BE-së dhe familjes sonë natyrale, europiane, është pa kthim. Këtë nuk e ndalon dot askush. Sa më shpejt ta kuptojnë, aq më mirë do të jetë edhe për ta, edhe për të gjithë.

Faleminderit shumë!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka kërkuar ministrja Etilda Gjonaj.

Etilda Gjonaj - E nderuar zonja kryesuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Është një përgjegjësi e madhe politike të diskutosh në këtë sallë çështjen e dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë të regjimit komunist.

Bëhet fjalë për një plagë të madhe, të cilën qeverisja e djathtë e ka trajtuar vetëm me shkrim, vetëm duke miratuar ligjin, por në asnjë rast nuk ka thënë se sa këste ka dhënë për ish - të përndjekurit politikë.

Është pikërisht qeverisja e majtë, PS-ja, e cila, në mënyrë të vazhdueshme, ka tentuar dhe ka zbatuar me rigorozitet ligjin, duke dhënë këstet për të përndjekurit politikë.

Të na thotë PD-ja një rast të vetëm se sa këste kanë marrë dhe sa kanë përfituar ish - të përndjekurit politikë gjatë qeverisjes së djathtë!

Qeveria “Rama”, që prej marrjes së mandatit, e ka pasur një prej prioritetëve të punës së saj zgjidhjen përfundimtare të çështjes së dëmshpërblimit të ish - të përndjekurve politikë dhe i ka kushtuar një vëmendje të veçantë kësaj problematike.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, synon finalizimin me sukses të detyrimit ligjor të shtetit shqiptar për përmbylljen e procesit të dëmshpërblimit për këtë shtresë sensitive të shoqërisë.

Që nga fillimi i procesit e kanë kërkuar këtë të drejtë rreth 24 291 qytetarë, duke paraqitur aplikimet e tyre pranë Ministrisë së Drejtësisë. Janë miratuar në total 13 118 kërkesa për dëmshpërblim të miratuara me VKM.

Ju bëj me dije se vetëm gjatë periudhës shtator 2017- shtator 2018 janë miratuar me VKM 165 përfitues në total, si dhe jemi në proces të ndryshimit të një VKM-je për masën e dëmshpërblimit për 80 ish-të dënuar (për korrigjimin e masës së dëmshpërblimit të tyre), që kanë përfituar me vendime të mëparshme të Këshillit të Ministrave.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar” propozohet si një nismë e përbashkët e tri ministrive, me qëllimin e vetëm përsheptimit e procedurave të

dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë të regjimit komunist, të cilët sot janë ende gjallë dhe bëjnë pjesë në kategorinë parësore, si dhe për familjarët e të burgosurve, e të ekzekutuarve dhe të internuarve. Në këtë kuadër, projektligji në fjalë rregullon heqjen e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku 70% i vihet në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahet kategorisë së trashëgimtarëve.

Së dyti, projektligji synon të rregullojë dëmshpërblimin e plotë për të gjithë ata ish-të dënuar, të cilët janë ende në jetë, por që për shkak të kufizimeve aktuale të ligjit në fuqi, ku përcaktohet ndarja e shumës së dëmshpërblimit në 8 këste, me vlerë maksimale 1 milion lekë, nuk kanë marrë dot të gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit. Ndërkohë, sot ekzistojnë subjekte parësore, të cilat e superojnë këtë vlerë dhe me vendim të Këshillit të Ministrave do t'u mundësohet marrja e kështit të 9-ë.

Së treti, ky projektligj rregullon trajtimin e subjekteve përfituese, ku vlera totale e miratuar deri në 1 milion lekë krijon mundësinë të likuidohet me një kësht të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.

Dëshiroj të theksoj se të gjitha ndërhyrjet e mësipërme ligjore, që sjellin ndryshime në mekanizmin e shpërndarjes së fondit të dëmshpërblimit, bëhen me qëllimin e vetëm për të shmangur burokracitë dhe lehtësuar dëmshpërblimin përfundimtar të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist.

Për pasojë, ndryshe nga sa është deklaruar në lidhje me këtë nismë edhe nga përfaqësuesit e opozitës, të cilët ende nuk na e kanë dhënë shifrën dhe kështet që kanë miratuar për këtë kategori, dua të theksoj se rishikimi i mekanizmit të shpërndarjes së fondeve të vëna në dispozicion për ish-të përndjekurit politikë nuk prek të drejtat, tashmë të fituara, të asnjë ish-të dënuari politik apo familjari të tij, si dhe nuk redukton dhe as nuk mohon masën totale të shpërblimit financiar të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për secilën kategori të subjekteve parësore.

Dua të theksoj fort se ky projektligj nuk prek as rishikimin e dëmshpërblimit të marrë nga ish-të përndjekurit.

Duke pasur parasysh karakterin thellësisht sensitiv të kësaj çështjeje, një propozim i tillë

është bërë në funksion të thjeshtimit të procedurave dhe finalizimit me sukses të detyrimit ligjor dhe moral, të kompensimit dhe rehabilitimit tërësor, me të cilin ngarkohet shteti ynë në lidhje me këto kategori subjektsh.

Të nderuar deputetë,

Dua të ritheksoj edhe një herë se me anë të këtij projektligji synohet të trajtohet dhe të rregullohet njëherë e mirë e gjithë problematika e së drejtës që u takon ish-të dënuarve politikë dhe të finalizohet me sukses detyrimi ligjor që shteti, qeveria shqiptare, ka për përmbylljen e procesit të dëmshpërblimit për këtë shtresë.

Ne kemi jo vetëm vullnetin politik, por e kemi treguar edhe me veprime konkrete që jemi mbështetës të një shtrese të popullsisë, që ka vuajtur pasojat çnjerëzore të një diktature komuniste.

Duke mbajtur në konsideratë se qeverisja e djathtë në asnjë rast nuk ka bërë të mundur që kjo shtresë të paguhet dhe të marrë dëmshpërblimin ashtu siç duhet dhe siç e meriton, ju ftoj të bëheni pjesë e zgjidhjes, duke nisur me miratimin e ndryshimeve të këtij projektligji.

Faleminderit!

(Duartrokjet në sallë)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Këtu përfundojnë diskutimet.

Kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputetja Evis Kushi.

Evis Kushi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot do të miratojmë një projektligj, i cili bën disa ndryshime në ligjin ekzistues për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist. Projektligji është vazhdim i punës së deritanishme të ndërmarrë nga qeveria shqiptare për mbajtjen e premtimit për një trajtim të ri, ndryshe, të ish-të dënuarve politikë, të cilët nuk u vlerësuan dhe nuk u rehabilituan siç duhet nga qeveritë e mëparshme.

Qëllimi kryesor i projektligjit është përmirësimi i formulës së dëmshpërblimit për të siguruar një mbështetje më të mirë financiare për personat që kanë vuajtur dënimin dhe janë ende në jetë apo për familjarët e tyre, si dhe për ta

përsheptuar dhe përfunduar sa më parë këtë proces.

Para se të hyj në detajet e këtyre ndryshimeve, dua të sjell në vëmendjen tuaj faktin që opozita, e cila përsëri sot nuk ndodhet në sallë, e ka kundërshtuar këtë projektligj me akuza të ndryshme nëpër medie apo me deklarata politike nga selia e Partisë Demokratike.

Për këtë arsye, besoj se është me vlerë që publiku të informohet me shifra dhe fakte, që lidhen me mënyrën si janë trajtuar ish-të përndjekurit politikë ndër vite.

Deri në vitin 2013, pra gati 23 vjet nga rënia e regjimit komunist, ish-të dënuarit politikë kanë arritur të përfitojnë vetëm 20% të vlerës së dëmshpërblimit për vitet e burgut dhe vuajtjet në regjimin komunist.

Partia Demokratike, e cila pretendon se e mbështet këtë kategori, gjatë kohës që ishte në pushtet dha vetëm 15 milionë dollarë për ish-të përndjekurit, kurse qeveria “Rama” vetëm në mandatin e parë akordoi për ish-të përndjekurit 70 milionë dollarë. Me shlyerjen e kështit të nëntë së shpejti, ne e mbyllim plotësisht detyrimin ndaj kategorisë parësore, atyre që e kanë vuajtur në mënyrë të drejtpërdrejtë dënimin.

Këto shifra janë më se të mjaftueshme për të treguar fare qartë diferencën. Mua më vjen shumë keq që opozita jo vetëm që nuk bëri për ta aq sa duhet gjatë kohës që ishte në pushtet, por edhe tani nuk po bën as minimumin e mundshëm për të mbështetur këtë projektligj. Madje edhe në muajin mars të vitit të kaluar, kur ne miratim ligjin që parashikonte shtyrjen e afatit të paraqitjes së kërkesave për përfitimin e dëmshpërblimit, opozita nuk ishte e pranishme në Komisionin e Ekonomisë dhe në seancën plenare. Si mund të pretendojë kjo forcë politike, që i mbështet ish-të përndjekurit kur nuk vjen për t’i diskutuar dhe votuar projektligjet në parlament? Ky është detyrim minimal dhe përgjegjësi minimale që deputetët e opozitës duhet të kenë dhe duhet të ndiejnë ndaj kësaj kategorie.

Për fat të keq, për shkak të mungesës së vëmendjes nga qeveritë paraardhëse, shumë ish-të përndjekur ndërruan jetë pa marrë asnjë kësht dëmshpërblimi. Për ne çështja e kompensimit të ish-të përndjekurve është e rëndësishme, një çështje morale e shoqërisë dhe jo çështje votash, prandaj ne e kemi trajtuar atë me shumë kujdes:

nga njëra anë t’u japim atyre atë që meritojnë dhe, nga ana tjetër, të mos lejojmë asnjë lloj abuzimi të mundshëm.

Do të ndalem tani në mënyrë pak më specifike të projektligjit. Siç e thashë pak më sipër, ky projektligj rishikon mekanizmin e shpërndarjes së fondeve, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të ish-të dënuarve politikë që janë ende në jetë dhe subjekteve të tjera të kategorisë parësore. Ai heq raportin 70% me 30% midis kategorisë parësore dhe trashëgimtarëve të tjerë, që është në ligjin ekzistues dhe parashikon që dëmshpërblimi të ndahet në mënyrë proporcionale midis të gjithë përfituesve.

Sipas të dhënave, dëmshpërblimi për subjektet përfituese parësore është realizuar në masën 90% dhe mbetet një diferencë e vogël e palikuiduar. Masat që propozohen me këtë projektligj do të sjellin ritme më të shpejta të shpërndarjes së dëmshpërblimit dhe përmbylljen e këtij procesi. Gjithashtu, projektligji krijon mundësinë që të gjitha subjektet përfituese parësore, të cilave u takon një vlerë totale dëmshpërblimi mbi 8 milionë lekë, ta përfitojnë të gjithë shumën e dëmshpërblimit, pasi, sipas ligjit ekzistues, këtyre subjekteve u kufizohet dëmshpërblimi deri në 8 milionë lekë. Projektligji i ri parashikon vijimin e shpërndarjes me kësht të dëmshpërblimit deri në shpërndarjen e plotë të tij. Po ashtu, krijohet mundësia që, kur vlera totale e dëmshpërblimit, e miratuar për të gjithë përfituesit, është 1 milion lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit të kryhet e plotë.

Të nderuar kolegë, është e vërtetë se borxhi, që ne të gjithë si shoqëri kemi ndaj kësaj shtrese, nuk mund të paguhet vetëm me para, por ky projektligj dhe të gjitha iniciativat e mëparshme të kësaj maxhorance janë dëshmi e pëmbushjes së premtimit për shlyerjen e të gjitha kësteve për dëmshpërblimin e kategorisë parësore brenda këtij mandati qeverisës, si dhe për mbështetjen, integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre në çështjet shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit.

I ftoj të gjithë kolegët e maxhorancës ta votojmë në mënyrë unanime këtë projektligj.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Kushi!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 SHTATOR 2018

ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar””.

Kolegë, para se të kalojmë në votim, bëjmë dy minuta pushim. Gjatë kohës që bëhemi gati për votim, kolegëve deputetë dhe deputete që nuk janë të pranishëm t’u hiqet karta.

(Rifilllon seanca)

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Rifillojmë seancën.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

74 deputetë janë të pranishëm.

Fillojmë me votimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Para se të kalojmë në procesin e votimit, ju rikujtoj nenin 85, pika 2, të Kushtetutës, i cili parashikon shprehimisht se dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Pra, për të rrëzuar dekretin e Presidentit kërkohen, të paktën, 71 vota kundër, në të kundërt dekreti konsiderohet i pranuar.

Është vetëm një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Asnjë pro, 74 kundër, asnjë abstenim.

Rrëzohet dekreti.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.1.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar””.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të propozuar.

Meqenëse komisioni përgjegjës nuk ka bërë vërejtje, fillojmë me nenet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 SHTATOR 2018

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kemi një votim të bartur nga seanca e parë, është projektligji

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Siç e dini, të dyja këto projektligje kërkojnë shumicë të cilësuar votash për miratim, tre të pestat e deputetëve, pra të paktën 84 vota pro.

Duke pasur parasysh që nuk ekziston kuorumi përkatës, ato shtyhen për në seancat e ardhshme.

Këtu mbyllet seanca.

Faleminderit për kontributin!

Seanca tjetër do të njoftohet nëpërmjet medias.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 13:00.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**